



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

2015 ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERAVE

Prodhimet pyjore jodrunore

2015 Regjioni i Mitrovicës





MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

2015 ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERAVE

2015 Prodhimet pyjore jodrunore

2015 Regjioni i Mitrovicës

MIRËNJOHJE

Financuar nga Ministria për Punë të Jashtme të Finlandës në kuadër të projektit “Ndihmë Tregtisë”.

ANALIZA E PËRGATITUR NGA:

Epi Centar International

KONTRIBUT I VEÇANTË I OFRUAR NGA:

Sigurimi i Cilësisë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë:

TEUTA PURRINI XHABALI, Menaxhere Projekti, projekti “Ndihmë Tregtisë”

ARTANE RIZVANOLLI, Konsulente e Jashtme

ANITA SMAILOVIC, Bashkëpunëtore në projekt, projekti “Ndihmë Tregtisë”

BARLET GOJANI, NUNV Asistent projekti, projekti “Ndihmë Tregtisë”

ERËBLINA ELEZAJ, Analiste për hulumtim, Ekipi për Politika, Hulumtim, Çështje Gjinore dhe Komunikim

IRIS DURI, Statisticiente, Ekipi për Politika, Hulumtim, Çështje Gjinore dhe Komunikim

BRIKENA SYLEJMANI, Bashkëpunëtore në Programin Gjinorë, Ekipi për Politika, Hulumtim, Çështje Gjinore dhe Komunikim

BURBUQE DOBRANJA, Bashkëpunëtore për Komunikim, Ekipi për Politika, Hulumtim, Çështje Gjinore dhe Komunikim

DANIJELA MITIĆ, Analiste për Komunikim, Ekipi për Politika, Hulumtim, Çështje Gjinore dhe Komunikim

Një mirënjohje e veçantë u takon të gjitha bizneseve të intervistuar dhe akterëve të tjerë relevant.

Ky dokument nuk ka të drejtë autoriale prandaj përmbajtja e tij mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të UNDP-së. Mirëpo, burimi i saj, duhet të citohet.

Analiza dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport i përkasin kontraktorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Ministrisë për Punë të Jashtme të Finlandës.

LISTA E SHKURTESAVE

Mitrovica e Jugut	Komunat Mitrovicë, Vushtrri dhe Skënderaj
Mitrovica e Veriut	Komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovica e Veriut
BE	Bashkimi Evropian
HACCP	Analiza e Rrezikut dhe Kontrolli i Pikave Kritike
IADK	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
IBCM	Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë
IPA	Politika Ndërkombëtare për Bujqësi
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
BMA	Bimët Mjekësore dhe Aromatike
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
PPJD	Produktet Pyjore Jodrunore
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
TUV	Inspektimi Teknik (origjinal Technischer Überwachungsverein)
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (origjinal Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE.....	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
1. HYRJE	8
2. METODOLOGJIA	9
3. PASQYRIM I SEKTORIT	10
3.1 Prodhuesit/Mbledhësit/Fermerët	12
3.2 Blerësit/tregtuesit/qendrat e grumbullimit	13
3.3 Përpunuesit	16
3.4 Eksportuesit.....	17
3.5 Shërbimet këshillimore	17
3.6 Ofruesit e lëndës për mbjellje	18
3.7 Laboratorët.....	18
3.8 Qasja në kapital	19
3.9 Transporti dhe Logjistika	19
3.10 Kompanitë e marketingut	20
3.11 Certifikimet	20
3.12 Edukimi	20
4. KARAKTERISTIKAT E KËRKESËS DHE OFERTËS	21
4.1 Gjendja në Mitrovicën e Jugut.....	21
4.2 Gjendja në Mitrovicën e Veriut	22
5. TREGTIA VENDORE DHE E JASHTME DHE TRENDET E TREGUT – PIKAT HYRËSE TË TREGUT DHE KONKURRENCA	26
6. LIDHJET HORIZONTALE DHE VERTIKALE.....	28
6.1 Lidhjet horizontale	28
6.2 Lidhjet vertikale.....	29
7. ÇËSHTJET KYÇE TË IDENTIFIKUARA NË RAJONIN E SYNUAR	30
7.1 Përparësitë	30
7.2 Dobësitë	30
7.1 Mundësitë	31
7.4 Rreziqet	32

8. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SEKTORIT	33
8.1 Çështjet rreth përmirësimit të mjedisit biznesor	33
8.2 Çështjet rreth përmirësimit të lidhjeve horizontale dhe vertikale	35
8.3 Çështjet rreth përmirësimit të marketingut të palëve të përfshira në Zinxhirin e Vlerav	36
8.4 Çështjet rreth përmirësimit të prodhimit të NVM-ve	38
8.5 Çështjet rreth përmirësimit të qasjes në kapital	40
Shtojca 1 – Lista e të intervistuarve.....	42
Shtojca 2 – Programet e donatorëve për nën-sektorin e PPJD-ve	44
Shtojca 3 - Referencat.....	48

FIGURAT

Figura 1 – Zinxhiri i vlerave të Produkteve Pyjore Jo-Drusore në Mitrovicë	10
Figura 2 – Paraqitja grafike e Zinxhirit të Vlerave në Mitrovicën e Veriut	11

TABELA

Tabela 1 - Shpenzimet e mbledhjes	21
Tabela2 - Shpenzimet e funksioneve të përpunuesve	22
Tabela 3 - Shpenzimet e mbledhjes - Mitrovica e Veriut.....	23
Tabela 4 - Shpenzimet funksionale të përpunuesve –Mitrovica e Veriut	24
Tabela 5 - Vlera mujore e eksporteve dhe importeve të PPJD-ve	26
Tabela 6 - Sasia mujore e eksporteve dhe importeve të PPJD-ve	27
Tabela 7 - Tregjet më të mëdha për eksport dhe import të PPJD-ve	27

1. HYRJE

Rajoni i synuar përbëhet nga Mitrovica e Veriut (komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovica e Veriut), dhe Mitrovica e Jugut (komunat: Mitrovica e Jugut, Vushtri dhe Skënderaj). Ky rajon ka aktivitet ekonomik i cili është shumë më i ulët se sa potenciali që ka, posaçërisht i favorshëm për grumbullimin dhe kultivimin e produkteve pyjore jo-drusore (PPJD). Lartësia mbidetare dhe konfiguracioni i terrenit janë të favorshme për aktivitete grumbullimi dhe kultivimi të disa llojeve të pemëve të egra dhe bimëve mjekësore, si dhe disa llojeve të manaferrave të kultivuara. Kosova¹ ka traditë të gjatë në grumbullimin e PPJD-ve siç janë kërpudhat që rriten në mënyrë të egër, bimët aromatike dhe mjekësore dhe manaferrat, por që ka humbur tregun me shkatërrimin e Jugosllavisë. Një problem shtesë ishte që Kosova asnjëherë nuk ka zhvilluar traditën e kultivimit të PPJD-ve. Sido që të jetë, duke iu falënderuar prodhuesve të cilët kanë mbajtur lidhje të mira biznesi me përpunues më të mëdhenj, grumbullimin i PPJD-ve ka filluar sërish. Më pas, falë përkrahjes nga iniciativat e ndryshme donatore në Kosovë, kjo industri është rritur shumë shpejt.

Kosova ka 481,000 ha² tokë pyjore. Sipas inventarizimit të PPJD-ve³, të përpiluar nga Departamenti i Botanikës i Fakultetit të Matematikës dhe Shkencave Natyrore të Universitetit Hasan Prishtina, Kosova ka potencial për të grumbulluar së paku 29,000 tonelata PPJD, duke përfshirë 85 lloje me potencial ekonomik siç janë rigoni, menta, primula veris, frutat e imëta të dëllinjës, kaça, lule basani, kamomili, njëmijëfletëshi, trumza Breckland⁴, etj.

Sot, rreth 11,400 grumbullues⁵, 100 kultivues, 40 qendra grumbullimi dhe 10 përpunues vlerësohen të jenë aktiv në Kosovë, shumica prej tyre në jug të Mitrovicës. Grumbullimi është kryesisht biznes familjar ku përfshihen barabartë të gjithë anëtarët e familjes. Qendrat e grumbullimit janë të organizuara nga grumbulluesit e mëdhenjë në rajone të vogla. Në tri deri pesë vitet e fundit të gjithë përpunuesit kanë bërë investime të mëdha në themelimin e hapësirave për ngrirje, hapësirave për ftohje dhe në makineri përpunimi. Kompanitë si EuroFruti, Agroproduct, Hit Flores dhe Fungo FF gjithashtu kanë investuar në implementimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe cilësisë së ushqimit siç janë HACCP, IFC dhe certifikimi organik.

Ndërkaq, hulumtimi primar i bërë për qëllime të këtij studimi sugjeron që rreth 1,050 familje në Mitrovicën Veriore janë të përfshira në grumbullimin e PPJD-ve. Këtu përfshihen mbi 2,000 njerëz. Kur merret parasysh numri i përgjithshëm i popullatës në Mitrovicën e Veriut, kjo shifër është e konsiderueshme. Në të njëjtën kohë ekzistojnë 40 deri 50 ferma⁶, të cilat në mënyrë aktive kultivojnë produkte të mjedrave dhe manaferrave, me një hapësirë mesatare të mbjelljes prej rreth 0.10 ha.

1 Referencat për Kosovën duhen kuptuar në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

2 MBPZHR – “Plani për Zhvillim Bujqësor dhe Rural 2009 – 2013”

3 http://www.helvetas-ks.org/HPK/documentation/technical_reports/101007RaportiiinvetaritteBMA dhePFE_en.pdf

4 Në anglisht: *Breckland Thyme*

5 Raporti HPK “Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të projektit në sektorin e PPJD-ve në Kosovë dhe korniza zhvillimore e aktiviteteve të projektit për 2012” – përpiluar nga Brigit Boor

6 Kultivimi është biznes familjar dhe në këtë rajon pronësia e tokës në shumicën e rasteve mbahet nga burri.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të identifikojë dhe të analizojë të gjitha aspektet e zinxhirit të vlerave në PPJD në rajonin e Mitrovicës. Përpilimi i analizës së zinxhirit të vlerave është organizuar në dy faza. Së pari, është bërë shqyrtimi i të gjitha studimeve dhe të dhënave ekzistuese lidhur me PPJD-të. Pas shqyrtimit fillestar të literaturës, ekipi i projektit ka mbledhur të dhëna përmes intervistave gjysmë tëstrukturuara me palët kyçe të interesit që përfaqësojnë nivele të ndryshme të zinxhirit të vlerave të PPJD-ve. Përzgjedhja e palëve kyçe të interesit është bërë duke marrë në konsideratë përfaqësimin e barabartë territorial dhe organizativ dhe duke siguruar mbulueshmëri të akterëve kyç në strukturat e ndryshme të zinxhirit të vlerave.

Për të analizuar aspektin e përkrahjes institucionale dhe mjedisin biznesor ekzistues, janë mbajtur intervista me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencisë Kosovare të Pyjeve, Komunës së Mitrovicës dhe Lepsaviqit. Specifikat e fuqisë punëtore dhe kërkesat për ngritje të kapaciteteve janë mbuluar përmes intervistave me profesorët e Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë, ofruesit e shërbimeve të fushave specifike dhe një numër të NVM-ve aktive në rajonin e Mitrovicës. Informatat lidhur me qasjen në kapital janë mbledhur përmes intervistave me një numër përfaqësuesish nga sektori bankar. Gjithashtu janë bërë përpjekje për të analizuar pjesëmarrësit indirekt në zinxhirin e vlerave si transporti, magazinimi, institucionet për siguri të ushqimit, logjistika dhe aspektet e marketingut. Aspektet e prodhimit dhe përpunimit në zinxhirin e vlerave, janë mbuluar nëpërmjet intervistave me prodhuesit dhe përpunuesit e rëndësishëm në rajonin e synuar.

Informatat e mbledhura ishin jetike për organizimin e analizës PMMR (SWOT) me të gjithë ekspertët e përfshirë, ku janë identifikuar të gjitha përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet. Ky proces gjithashtu i ka mundësuar ekipit që të përgatisë një grup rekomandimesh fillestare për zhvillimin e intervenimeve sistematike për përmirësimin e konkurrueshmërisë së zinxhirit të vlerave. Për të shqyrtuar se sa janë relevante intervenimet e propozuara për ndryshime në zinxhirin e vlerave, janë organizuar dy fokus grupe të ndara në Vushtrri dhe në Mitrovicë për pjesëmarrësit nga jugu, përkatësisht veriu i Mitrovicës. Në të dyja grupet e fokusit janë bërë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e palëve të interesit nga sektorët kyç nga të gjitha aspektet e zinxhirit të vlerave. Rekomandimet dhe intervenimet e propozuara të paraqitura në këtë dokument i referohen diskutimeve dhe komenteve të marra nga palët e interesit nga sektorët kyç që ka çuar në zhvillimin e dokumentit i cili pasqyron nevojat reale dhe identifikon zbrazëtirat në sektorin e PPJD-së.

3. PASQYRIM I SEKTORIT

Pjesëmarrësit e drejtpërdrejt në zinxhirin e vlerave janë subjekte apo palë të interesit të lidhur që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionet themelore të zinxhirit të vlerave. Zinxhirët e vlerave të Jugut dhe Veriut të Mitrovicës janë paraqitur në Figurat 1 dhe 2 më poshtë, ndërsa përshkrimi i gjendjes në segmentet e ndryshme të pjesëmarrjes është paraqitur në pjesën tjetër të këtij dokumenti.

Figura 1 – Zinxhiri i vlerave të Produkteve Pyjore Jo-Drusore në Mitrovicë





Figura 2 – Paraqitja grafike e Zinxhirit të Vlerave në Mitrovicën e Veriut ⁷

⁷ Figura 2 përfshinë vetëm disa pjesë të zinxhirit të vlerave të identifikueshme gjatë hulumtimit. Pjesë të zinxhirit të vlerave, ekzistencën e të cilave nuk kemi qenë në gjendje të identifikojmë apo që aktualisht nuk janë duke e përmbushur rolin e vet në zinxhirin e vlerave (p.sh. ekzistojnë institucione financiare që operojnë në rajon, por ato nuk janë duke përkrahur projektet në bujqësi apo industrinë ushqimore), nuk janë të përfshira në diagram. Organizatat për ofrimin e shërbimeve konsulente në industrinë e ushqimit (si organizatat në fushën e kontrollit të cilësisë, sigurisë së ushqimit dhe standardizimit) nuk janë identifikuar dhe nuk janë përfshirë në diagram. Organizatat si shoqatat e grupet e fermerëve dhe format tjerat të shoqatave në sektor nuk janë identifikuar gjatë intervistave në terren. Roli i MBPZHR-së dhe MMPH-së në rajonin e Mitrovicës veriore është i kufizuar.

3.1 Prodhuesit/Mbledhësit/Fermerët

<p>Gjetjet e përgjithshme</p>	<p><u>Mbledhësit</u> janë njerëzit/familjet që jetojnë në zona rurale me potencial për mbledhjen e PPJD-ve duke përfshirë të gjithë anëtarët e familjes. Varësisht nga kërkesa dhe çmimi, mbledhësit mbledhin lloje të ndryshme të PPJD-ve gjatë ditës dhe në mbrëmje i shesin produktet e tyre drejtpërdrejt tek qendrat e grumbullimit dhe tek përpunuesit, duke u kompensuar me pagesë me para të gatshme në vendin e shitjes. Mbledhja kryhet me dorë, megjithatë për disa produkte përdoren vegla pune. Shumica e mbledhësve përdorin qese të përdorura të plastikës, thasë apo kontejnerë plastike varësisht nga produktet, por mbledhësit me certifikatë organike përdorin shporta të përgatitura enkas, të cilat ruajnë produktin nga dëmtimi. Shumica e produkteve të mbledhura shiten brenda së njëjtës ditë; mbledhësit rrallëherë kryejnë tharjen (tharjen në diell) apo trajtimin pas mbledhjes, siç është pastrimi apo kategorizimi, pasi që u mungojnë mjetet për aktivitete të tilla, edhe pse kanë njohuri për këtë.</p> <p><u>Kultivuesit</u> e BMA-ve – ekzistojnë dy lloje kultivuesish në një hapësirë totale prej 250 ha;</p> <p>* <i>Fermerët me kapacitete të ulta</i> të cilët kanë zëvendësuar mbjelljet e mëparshme (p.sh. drithërat apo perimet në shkallë të vogël të prodhimit) me kultivimin e PPJD-ve duke parë potencialin për të hyra më të mëdha nga ferma. Ata ose përkrahen nga donatorët, ose nga përpunuesit të cilët u ofrojnë atyre fidane dhe gjëra tjera për mbjellje dhe dakordohen që të blejnë produktin final në momentin e vjeljes.</p>
<p>Mitrovica e Jugut</p>	<p>Dy qendra grumbullimi/nën-operatorë kanë theksuar se blejnë produkte nga së paku 500 mbledhës nga 40 fshatra; besohet se për gjysmën e tyre, mbledhja e PPJD-ve është burim kryesor i të hyrave.</p> <p>Ekzistojnë rreth 90 kultivues me një sipërfaqe kultivimi prej 0.05 – 0.3 ha; në përgjithësi janë rreth 85 ha.</p> <p>Në hapësirën e synuar ekzistojnë rreth 35 fermerë me kapacitete të ulëta që kultivojnë lloje të BMA-ve si mëllaga, rigon, sherbeli dhe mëllagë të zezë. Këta prodhues janë përkrahur nga IADK-ja përmes ofrimit të materialit për mbjellje dhe këshillave teknike.</p> <p>* <i>Kultivuesit më të mëdhenj</i> – ekziston përpunuesi nga Istogu "Agroproduct", i cili ka 16 llojenë një hapësirë të përgjithshme kultivimi prej 145 ha, si dhe dy kultivues tjerë më të mëdhenj me një hapësirë të përgjithshme prej 20 ha. Është shumë e rëndësishme të ceket se në Mitrovicë nuk ka grumbullues apo integruer të PPJD-ve. Të gjithë akterët kyç në këtë sektor nuk gjenden në zonën e hulumtimit, sidoqoftë ata luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të PPJD-ve në rajonin e synuar përmes ofrimit të shërbimeve për të gjitha palët e interesuara.</p> <p>Në rajonin e Mitrovicës ekziston një kultivues më i madh i BMA-ve – mëllagë, mentë dhe sherbele me një hapësirë prej 7 ha. Ai është i lidhur me "Agroproduct"-in i cili e ka furnizuar me fidanë dhe i ka dhënë këshilla në fermë.</p> <p><u>Kultivuesit e frutave të imëta (manaferrave)</u> – Një numër projektesh kanë promovuar prodhimin e frutave të imëta si dredhëzat dhe mjedrat në rajonin e Mitrovicës gjatë 10 viteve të fundit duke furnizuar me material për mbjellje, këshillim në fermë dhe përmirësim të marketingut për fruta të imëta.</p> <p>Frutat e imëta kryesore të prodhuara janë dredhëzat dhe mjedrat. Tregu i Kosovës pothuajse është i ngopur me dredhëza vendore, megjithatë furnizimi i materialit për mbjellje (fidanë) është ende i paqëndrueshëm pasi që qendrat kopshtare nuk furnizojnë materialin për mbjellje të cilësisë së duhur.</p>

Mitrovica e Veriut

Bazuar në intervistat e kryera për qëllime të këtij raporti, rreth 1,050 familje janë të përfshira në aktivitete komerciale të mbledhjes, ndonëse asnjëra nga ato nuk varen vetëm nga ky aktivitet. Mbledhësit shesin produktet e tyre (të thara dhe të freskëta) në tregun vendorë në Mitrovicën e Veriut. Niveli i njohurive lidhur me mundësitë për mbledhje është i ulët, kështu që p.sh. disa lloje të kërpudhave nuk mblidhen fare pasi që mbledhësit nuk i njohin ato (p.sh. Morela dhe Amanita Caesarea).

Kohëve të fundit ka pasur interesim të gjerë për kultivimin e frutave të imëta, pasi që të hyrat vjetore nga ky lloj prodhimi sillen prej 3,500 € deri në 4,000 € nga plantacionet në madhësi prej 0.10 ha. Prodhimtaria arrin deri në 20 t/ha (për manaferrat) me çmim të blerjes rreth 2 €/kg, që do të thotë se një fermë mund të rrisë konsiderueshëm të hyrat e saj duke kultivuar dredhëza të egra, mjedra dhe manaferra. Numri i atyre që janë të interesuar për këtë lloj prodhimi është në rritje të qëndrueshme dhe aktualisht rreth 55 fermerë janë të përfshirë në këtë aktivitet.

Gjithashtu ka fermerë që sapo kanë filluar kultivimin e dredhëzave të egra. Të gjitha frutat e kultivuara shiten në tregjet vendore, por jo në mënyrë të organizuar për të siguruar treg të qëndrueshëm dhe kultivim të kontraktuar.

3.2 Blerësit/tregtuesit/qendrat e grumbullimit

Gjetjet e përgjithshme

Qendrat e vogla të grumbullimit/Grumbulluesit – udhëhiqen nga njerëzit që jetojnë në zonat rurale e që blejnë produktet nga mbledhësit në baza ditore, në emër të nën-operatorëve apo operatorëve/përpunuesve duke fituar komision në përqindje të blerjes. Këto qendra kanë depo më të vogla pa hapësira për tharje apo ftohje. Punë e ngjashme bëhet edhe nga disa banorë të tjerë të zonave rurale që blejnë produkte në emër të përpunuesve (p.sh. kërpudha dhe boronica). Në parim, aty bëhet vetëm grumbullimi i produkteve – mbledhja e sasive të vogla nga mbledhësit, grumbullimi dhe transportimi i produkteve tek përpunuesi apo menaxhimi direkt i shitjeve si eksporte, por në sasi të vogla, kryesisht me kërpudha. Produktet gjithmonë paguhet në vendin e shitjes – nuk ka pagesa të mëvonshme. Gjithsej janë 30 qendra grumbullimi.

Nën-operatorët – këto janë biznese që kanë infrastrukturën për të tharë dhe/ose për të ftohur dhe magazinuar produktet e mbledhura. Këto biznese blejnë produktet nga qendrat e grumbullimit dhe/ose nga mbledhësit në vartësi nga kapacitetet e tyre përpunuese dhe të magazinimit. Këto biznese janë në pozitë për të zgjedhur blerësit potencial dhe meqenëse produkti mund të magazinohet dhe të ruhet si duhet, kjo ndikon që ata të kenë fuqi më të madhe në marrëveshjen për shitje krahasuar me qendrat e grumbullimit. Në Kosovë janë funksionale gjithsej rreth 40 qendra grumbullimi që gjithashtu grumbullojnë sasi më të mëdha dhe llojllojshmëri më të madhe të produkteve (barëra, fruta të imta dhe kërpudha).

Sfidat me të cilat mbledhësit/përpunuesit ballafaqohen kanë të bëjnë me mjedisin biznesor, procesin e prodhimit (mungesën e rregulloreve dhe fushën e parregulluar të punës dhe biznesit, procesin e prodhimit, mungesën e përkrahjes bankare, mungesën e strategjisë institucionale për bujqësi, mbulueshmëri të ulët dhe të kufizuar të proceseve me teknologji, mungesën e pajisjeve për prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar (ambalazhim të vogël të produkteve të cilësisë së lartë, pajisjeve për prodhimin e produkteve me afat të gjatë qëndrueshmërie), mungesën e aktiviteteve të marketingut, dhe mungesën e shoqatave të prodhuesve dhe shërbimeve këshilluese rurale).

Mitrovica e Jugut

Në rajonin e analizuar ekzistojnë dy qendra grumbullimi/nën-operatorë, që ndodhen në Bajgorë dhe në Skënderaj.

Qendra e grumbullimit në Bajgorë bashkëpunon me 200 deri 300 mbledhës të PPJD-ve, në 22 fshatrat përreth, ku banojnë rreth 12,000-13,000 banorë. Për rreth 50% të tyre, mbledhja e PPJD-ve është burimi kryesor i të hyrave. Qendra e grumbullimit operon me dy tharës dhe dy automjete/furgona me të cilat transporton produktet nga viset e largëta. Qendra e grumbullimit është përkrahur nga donatorët me ngritje të kapaciteteve, duke përfshirë trajtimin pas vjeljes. Produktet kryesore me të cilat merret qendra e grumbullimit janë kërpudhat, agulicja, frutat e imëta të dëllinjës, kaça dhe shtogu.

Qendra e grumbullimit në Skënderaj (AgroFlorentina) luan rolin e qendrës së grumbullimit, përpunuesit dhe eksportuesit. Produktet kryesore janë kërpudhat (5 lloje të ndryshme), frutat e imëta të dëllinjës, kaça, molla e egër dhe boronica. Kohëve të fundit kompania ka ndërtuar hapësira me sipërfaqe prej 600m² duke përfshirë hapësirat për ftohje e ngrirje si dhe tharësit.

Të dyja qendrat e grumbullimit janë të lidhura me kompani më të mëdha që bëjnë eksportin siç janë Agroproduct për BMA-të dhe AgroFlorentina për frutat e imëta. Qendrat e grumbullimit kanë deklaruar se po të kishte kërkesë ata do të mund të rrisnin mbledhjen me 50%.

Në përgjithësi nuk ka ndonjë edukim formal për mbledhësit. Vetëm projektet e donatorëve dhe eksportuesit e mëdhenj ofrojnë disa trajnime lidhur me këtë temë.

Mitrovica e Veriut

Gjatë hulumtimit janë identifikuar katër ndërmarrje që bëjnë blerjen dhe përpunimin e frutave të imëta dhe kërpudhave, ndërkaq asnjë nuk mbledhte barëra⁸.

Tri kompani janë të vogla për nga madhësia dhe gjenden në territorin e komunës së Leposaviqit, ndërkaq e katërta dhe më e madhja, gjendet në territorin e komunës së Zubin Potokut dhe është regjistruar si kooperativë në vitin 2011. Këto ndërmarrje kanë një qarkullim vjetor prej 100,000.00 € (të voglat) deri në 600,000.00 € (më e madhja, "ZZ Zubin Potok"). Produktet që blihen janë kërpudhat e egra (të thara dhe të freskëta), boronicat dhe frutat tjera pyjore (dredhëzat e egra, manaferrat), dredhëzat e kultivuara dhe mjedrat e kultivuara.

Së bashku ato kanë pajisje për ngrirje të shpejtë (me kapacitet që sillet prej 3t deri në 12t për një cikël) si dhe kapacitet për tharje deri në 5t për cikël. Kapaciteti i magazinimit sillet prej 70t deri në 1,500t.

Plantazhet më të vogla punësojnë më pak se 10 punëtorë me orar të plotë, ndërkaq tek plantazhi më i madhë janë 50 punëtorë. Numri i vlerësuar i punëtorëve të punësuar nga kooperativa në baza vjetore është rreth 150 punëtorë (me orar të plotë dhe sezonal). Plantazhet më të vogla punësojnë mesatarisht 25 deri 50 punëtorë për punë sezonale. Struktura e fuqisë punëtore është e balancuar; me numër të barabartë të burrave dhe grave të punësuar. Asnjëra nga këto ndërmarrje nuk kanë sisteme të certifikuar për siguri të ushqimit apo standarde që e rregullojnë këtë fushë. Vetëm "ZZ Zubin Potok" ka implementuar sistemin HACCP.

Nuk ka bashkëpunim afatgjatë ndërmjet mbledhësve dhe qendrave të grumbullimit kështu që nuk bëhet kontrolli i cilësisë dhe përzgjedhja e lëndës së parë. Kjo është e leverdishme për ndërmjetësuesit e vegjël të cilët në disa raste gjenden ndërmjet këtyre dy pjesëmarrësve të zinxhirit të vlerave. Roli i ndërmjetësuesve në zinxhirin e vlerave është i vogël dhe i kufizuar në transportin e mallrave nga mbledhësit tek blerësit. Ata nuk kanë kapacitete magazinimi dhe nuk rrezikojnë aktivitetin biznesor të blerësve. Në këtë mënyrë, materiali i papërpunuar shkon nga Mitrovica e Jugut (dhe mbarë Kosova) në Mitrovicën e Veriut, edhe pse zyrtarisht nuk ka tregti ndërmjet këtyre dy rajoneve.

Produktet e prodhuara në këto qendra më të mëdha grumbullimi nuk kanë vlerë të lartë të shtuar pasi që ato janë kryesisht ambalazhim industrial i produkteve të ftohura (të freskëta), të ngrira apo të thara, të destinuara për përpunim të mëtutjeshëm. Ekziston vetëm një kompani përpunuese që organizon pastrimin dhe ambalazhimin e materialit të përshtatshëm për transport tek qendrat tjera të shitjes me shumicë. Megjithatë, produktet e përpunuara pakëtohen në ambalazhime relativisht të mëdha prej 2.5 kg dhe nuk janë plotësisht të finalizuara (siç është ambalazhimi prej 0.125 kg i boronicave apo 0.250 kg i dredhëzave në atmosferë të modifikuar, që mund të gjendet në supermarkete). Siç cekëm më herët, deri më tani përpunimi është bërë vetëm në një fabrikë. Grumbulluesit/përpunuesit në të njëjtën kohë janë edhe eksportues.

3.3 Përpunuesit

<p>Gjetjet e përgjithshme</p>	<p>Këto janë biznese të regjistruara të cilat blejnë sasi të mëdha të produkteve për eksport. Përpunuesit bëjnë planin vjetor të grumbullimit, si në aspektin sasior ashtu edhe çmimit, dhe informojnë akterët tjerë për atë se çka duan të blejnë. Ata përcaktojnë çmimet dhe në shumicën e rasteve i parapaguajnë të tjerët për të blerë produktet. Ata përpunojnë, kategorizojnë dhe ambalazhojnë produktet sipas kërkesës. Sidoqoftë, ata janë të përfshirë në organizimin e grumbullimit, përpunimit dhe eksportit; njëri nga ta madje është i përfshirë në prodhimin e materialit për mbjellje dhe kultivim – për këtë arsye ata gjithashtu quhen operatorë. Ekzistojnë 9 përpunues që punësojnë së paku 100 punëtorë me orar të plotë dhe 500 punëtorë sezonal, e që ndodhen kryesisht jashtë rajonit të Mitrovicës. Bazuar në intervistat në terren, rreth 80% e fuqisë punëtore të angazhuar janë femra që korrespondon me gjendjen në një rajon më të gjerë.</p>
<p>Mitrovica e Jugut</p>	<p>Kompania Agroproduct nga Istogu është shumë aktive edhe pse nuk gjendet në Mitrovicë. Ajo ofron material për mbjellje për kultivuesit dhe për sa i përket produkteve të egra, ajo ka kontrata me qendra grumbullimi.</p> <p>Agroproduct ka 33 punëtorë me orar të plotë dhe 200 punëtorë sezonal. Ajo ka 3,250 mbledhës të regjistruar që lidhen me 40 qendra grumbullimi në mbarë Kosovën, nga të cilat tri gjenden në rajonin e Mitrovicës. Tregu është kryesisht i orientuar kah eksporti drejt tregjeve të Evropës perëndimore.</p> <p>Aktualisht proporcioni kultivim – mbledhje i kompanisë është 30% me 70%, por kur merren parasysh përparësitë e kultivimit për përpunuesit, ky proporcion ka tendencë të rritjes në 50% me 50%. I tërë prodhimi i kompanisë është organik dhe i certifikuar. Kompania ka disa tharës modern me sistem të ngrohjes qendrore dhe posedon linjën e përpunimit për produktet e mbledhura. Kompania punon me së paku 50 lloje – kryesoret janë agulicja, mëllaga, mëllaga e zezë, bliri, shtogu, kaça, boronicat, menta dhe bari i bletës.</p>
<p>Mitrovica e Veriut</p>	<p>Gjatë hulumtimit, përveç tharjes dhe ngrirjes së produkteve, nuk janë identifikuar lloje tjera fabrikash që funksionojnë aktualisht në përpunim. Është identifikuar vetëm një fabrikë për prodhimin e vajit eterik, infrastruktura e së cilës ishte në ndërtim e sipër. Investitori i kësaj fabrike është ndërmarrja private "Peppermint" nga fshati Vuçë, komuna e Leposaviqit, e përkrahur me grant të dhënë nga Zyra e BE-së në Kosovë (Skema e granteve EURED III)⁹.</p> <p>Kjo fabrikë prodhuese planifikon të punësojë 12 deri në 17 punëtorë dhe të angazhojë rreth 150 fermerë – nënkontraktues. Ajo do të përmbajë një laborator të vogël, magazinën e ftohtë, distilerinë e cila do të distilojë shumë lloje bimësh si dëllinjën, kumbullën dhe manaferrën¹⁰. Edhe pse fabrika është në një fazë të hershme të punëve ndërtimore, pronari planifikon të fillojë me punë në sezonin e vitit 2015.</p> <p>Planet e pronarit të fabrikës janë shumë ambicioze dhe kërkojnë angazhim të gjërë të fuqisë punëtore vendore duke arritur marrëdhënie kontraktuale me nën-kontraktues që do të rrisnin Valerian (Valeriana officinalis), Angelica archangelica, që njihet shpesh si angelika e kopshtit dhe bazilin apo bazilin e ëmbël (Ocimum basilicum) për qëllime të procesit të prodhimit. Tregu i targetuar për vajin eterik është Serbia dhe Rusia.</p>

3.4 Eksportuesit

<p>Gjetjet e përgjithshme</p>	<p>Përpunuesit kryesorë kosovarë janë gjithashtu eksportues. Përpunuesit kanë lidhje me tregjet e eksportit dhe blejnë produktet duke i ndjekur kërkesat e këtyre tregjeve. Ata kryesisht ndodhen jashtë Mitrovicës, por vazhdimisht blejnë produkte nga ky rajon.</p> <p>Kompanitë nga Serbia që bashkëpunojnë me kompanitë nga Kosova (nga i gjithë territori, jo vetëm nga Mitrovica e Veriut) kanë probleme me rregullimin e formës legale të blerjes, prandaj ky është një faktor kufizues në bërjen e tregtisë.</p> <p>Për të tejkaluar këtë situatë, bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve nga jugu i Kosovës dhe ndërmarrjeve nga Serbia është arritur përmes kompanive nga territori i Bujanocit dhe Preshevës, ndërsa bashkëpunimi me ndërmarrjet nga veriu i Kosovës është i drejtpërdrejt.</p>
<p>Mitrovica e Jugut</p>	<p>Eksportuesit kryesor janë Agroproduct dhe Agroflorentina. Agroproduct eksporton për tregjet e Evropës Perëndimore si Gjermania (70%), Austria (20%), Zvicra (10%), në vlerë vjetore deri në 1,500,000 €. Ajo ka tri kontrata afatgjatë me blerësit e saj, gjë që është mjaft e rrallë në tërë rajonin e Ballkanit. AgroFlorentina së fundmi ka filluar me eksportimin e dëllinjave për në Gjermani dhe të boronicave në Holandë.</p> <p>Kërpudhat nga zonat e targetuara kryesisht eksportohen në Serbi për shkak të pozitës gjeografike dhe lidhjeve të mira; për eksporte të tilla ekziston bashkëpunim ndërmjet kompanive nga Mitrovica e Jugut dhe ajo e Veriut dhe shpesh bëhet përmes kanaleve jozyrtare.</p>
<p>Mitrovica e Veriut</p>	<p>Në zonën e synuar nuk janë identifikuar eksportues të specializuar. Të gjithë blerësit/përpunuesit e identifikuar janë në të njëjtën kohë eksportues dhe i shesin produktet e tyre shitësve me shumicë në Serbi (mbi 90%). Tërthorazi, përmes blerësve nga Serbia, produktet nga ky rajon gjithashtu arrijnë në një numër të madh të shteteve të BE-së dhe në Rusi (në vitin 2014 një eksportues gjithashtu ka eksportuar për në SHBA).</p>

Pjesëmarrësit e tërthortë në zinxhirin e vlerave janë grupet dhe subjektet që janë pjesë e zinxhirit të vlerave duke shërbyer si përkrahje në funksionet e zinxhirit bazë të vlerave, siç janë shërbimet e zgjeruara, ofruesit e materialit për mbjellje, laboratorët, qasja në kapital, etj. Pjesa tjetër e këtij seksioni flet për këta pjesëmarrës.

3.5 Shërbimet këshillimore

Në Mitrovicën e Jugut, ekzistojnë tri lloje të shërbimeve këshillimore: 1) shërbimet publike të organizuara përmes MBPZHR-së dhe strukturave komunale, të cilat janë në fazën fillestare të zhvillimit andaj aktualisht janë të dobëta; 2) këshillimi i ofruar përmes projekteve zhvillimore. IADK-ja është shembulli më i mirë. Ajo ka ofruar këshilla rregullisht për të gjitha palët, si për proceset e mbledhjes ashtu edhe për ato të kultivimit, dhe akterët nuk është dashur të paguajnë për shërbimet e ofruara. Shërbimet e IADK-së janë financuar nga donatorët dhe si të tilla nuk janë të qëndrueshme.

9 Burimi: <http://www.rdanorth.org/>

10 Të dhënat e nxjerra përmes intervistave

3) Modeli i integruar i Agroproduktit – ofrimi i këshillave për fermerët në fermë nga përpunuesit. Kjo në tërësi udhëhiqet nga sektori privat. Në Mitrovicën e veriut, nuk ka struktura të organizuara përkrahëse që ofrojnë edukim falas apo me pagesë dhe përkrahje për palët e interesit të zinxhirit të vlerave, përveç “Qendrës Biznesore në Zveçan” e cila është nën programin e financuar nga donatorë për të mbështetur ndërmarrësinë ndër gra e të rinj në Kosovën Veriore ku organizohen trajnime, njëra nga të cilat është e fokusuar në metodat moderne të prodhimit të pemëve.

3.6 Ofruesit e lëndës për mbjellje

Në Mitrovicën e Jugut ekzistojnë rreth 100 biznese të regjistruara, tregtues të lëndës për mbjellje, furnizues të farës, pesticideve dhe materialeve tjera (p.sh. kasete për mbjellje dhe substrat) për prodhimin e lëndës mbjellëse. Në mënyrë më specifike, për kultivimin e PPJD-ve, ka prodhim të organizuar të fidanëve. Një numër i përpunuesve vendorë i shpërndajnë këta fidanë tek kultivuesit e kontraktuar duke iu garantuar blerjen e prodhimit të tyre. Sa i përket prodhimit të frutave të imëta, ekziston një kërkesë e lartë për fidane; megjithatë, qendrat kopshtare furnizuese vendore ofrojnë numër të kufizuar të fidaneve të cilësisë së ulët dhe jo të standardizuar. Qendrat kopshtare furnizuese kryesore gjenden jashtë rajonit të Mitrovicës, në Deçan, Shtime dhe Gjakovë. Dy vite më parë, me përkrahjen e projektit NOA të USAID-it, një qendër kopshtare për prodhimin e fidaneve të mjedrave ishte themeluar në Podujevë – ajo është zhvilluar mjaft mirë me fidane të certifikuar dhe të cilësisë së mirë.

Pesticidet që janë në dispozicion në treg në përgjithësi janë të cilësisë së ulët. Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë posedon teknologjinë për të kryer analiza, por i mungojnë burimet njerëzore. Kompanitë më të mëdha dhe prodhuesit importojnë vet pesticidet apo gjejnë kanalet e përshtatshme për furnizim të tyre, për faktin se ato janë më të mëdha dhe blejnë sasi më të mëdha. Në Mitrovicën e veriut nuk janë identifikuar prodhues të materialit për mbjellje. Të gjitha materialet për mbjellje (farërat, fidanet, pesticidet, kemikalet tjera, ambalazhimi, etj.) janë të importuara.

Bazuar në intervista, ekziston një problem me blerjen e pesticideve që shkaktohet nga procedurat e ngadalshme për marrjen e lejeve si dhe për shkak të çështjeve tjera administrative. Materialet më të zakonshme për mbjellje si farërat dhe fidanet kryesisht blihen nga Serbia, ndërkaq pesticidet dhe kimikatet tjera blihen nga Serbia dhe shtetet evropiane. Një problem potencial është blerja e fidaneve të pa-certifikuar dhe mungesa e informatave lidhur me rreziqet e prodhimit që kjo blerje i bartë me vete.

3.7 Laboratorët

Në Kosovë ekzistojnë dy laboratorë publik dhe një numër i laboratorëve privat që kryejnë analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike. Meqenëse sektori i PPJD-ve është i orientuar kah eksporti dhe produktet duhen analizuar para se të eksportohen, këto institucione janë shumë të rëndësishme për sektorin. Laboratorët kryesor publik janë Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë dhe Instituti i Shëndetit Publik në Prishtinë.

IBK-ja ofron shërbime për analizat e sipër-përmendura në mënyrë që të merren analizat fito-sanitare të produkteve para se ato të eksportohen (është obligative për eksport). Të dy laboratorët ofrojnë analiza të cilësisë së produktit dhe analiza të sigurisë ushqimore (p.sh. përqindja e lagështisë apo ndonjë analizë tjetër të kërkuar nga porositësi).

Në Mitrovicën e Veriut, kontrolli i cilësisë së produkteve paraqet një problem të konsiderueshëm pasi që në atë pjesë nuk ka laboratorë të akredituar. Kompanitë që janë të interesuara për eksport në tregjet e BE-së duhet të dërgojnë mostrat në Prishtinë apo Pejë për analiza edhe pse aktualisht shumica e kompanive përdorin laboratorët në Beograd. Kur mallrat transportohen në Serbi, analizat shpesh nuk janë të obligueshme. Një problem shtesë është fakti që nuk ka njohje të ndërsjellë të akreditimit të laboratorëve nga Kosova dhe Serbia andaj është një obligim që bartet nga blerësi (produktet eksportohen më tutje kryesisht në vendet e BE-së, prandaj analizohen në laboratorët e akredituar në Serbi). Inspeksioni fito-sanitar i Kosovës është përgjegjës për kontrollimin e mallrave në hyrje të Kosovës. Fakulteti i Teknologjisë i themeluar rishtazi në Mitrovicën e Veriut ka ndërmarrë një iniciativë për themelimin e laboratorit në fakultet, por vetëm për analiza kimike të produkteve. Themelimi i laboratorit për momentin është në fazën fillestare me mungesë të pajisjeve, personelit të trajnuar dhe mungesë akreditimi. Themelimi i këtij laboratorit mund të zgjidhë shumë probleme me të cilat ballafaqohen kompanitë vendore.

3.8 Qasja në kapital

Në Kosovë, duke përfshirë Mitrovicën e Veriut, kreditë dhe produktet tjera financiare janë të shtrenjta dhe të papërshtatshme. Përpunuesve u nevojiten shuma të mëdha të mjeteve qarkulluese për të financuar blerjen e lëndës së parë; bankat kanë ofruar vetëm mbitërheqjen në shuma shumë më të ulëta se ato të nevojshme – për një produkt të tillë bankat kërkojnë mjete që regjistrohen si peng dhe kontratat e nënshkruara me blerës ndërkombëtarë nuk pranohen si garanci. Bujqësia mbulon vetëm 3% të portofolios së përgjithshme kreditore në Kosovë. Banka Ekonomike Turke (TEB) ka startuar me një produkt të ri vitin e kaluar – Agro Karta; është një kredit kartelë me të cilën fermerët apo kompanitë e përfshira në bujqësi mund të blejnë produktet e nevojshme për investime në fermë apo shpenzime që mund të kthehen deri me gjashtë muaj vonesë. Sidoqoftë vetëm disa nga ta duket se janë duke i përdorur.

Në Mitrovicën e Veriut, qasja në kapital është problemi kryesor me të cilin ballafaqohen ndërmarrjet dhe fermat. Në këtë zonë ekzistojnë një numër bankash (Raiffeisen Bank, Nova Ljubljanska Banka (NLB), Jug Banka dhe Komercijalna Banka); megjithatë, asnjëra nga to nuk ofrojnë linja krediti për të përkrahur prodhimin dhe zhvillimin e këtij sektori. Bankat nuk japin kredi pasi që pagesat nuk janë të rregullta, pengi i kompanive nuk është i regjistruar fare tek institucionet kosovare, zbatimi i ligjit dhe funksionet e sistemit gjyqësor nuk janë në funksion. Nivelin e rrezikut bankar rritet shumëfish pasi që zotimi nuk mund të garantohet me asnjë sistem dhe pengi fare nuk mund të konfiskohet. Prandaj, ato preferojnë që të mos rrezikojnë dhe nuk japin kredi.

3.9 Transporti dhe Logjistika

Në Mitrovicën e Jugut dhe në mbarë Kosovën, kompanitë e transportit ofrojnë shërbime transporti për qëllime eksporti. Operatorët kryesisht përdorin kompanitë ndërkombëtare para atyre vendore për shkak të çmimeve më të ulëta, pasi që kompanitë kosovare kanë shpenzime më të larta të sigurimit (p.sh. kartoni i gjelbër ende nuk mund të blihet për makinat e regjistruara në Kosovë). Në Mitrovicën e Veriut, nuk është identifikuar as edhe një kompani shpedicioni, kështu që të gjithë pjesëmarrësit në zinxhirin e vlerave mbështeten në transportin e tyre personal (në nivelin vendorë, si dhe për transportin e materialeve të papërpunuara – lëndës së parë), apo në transportin e ofruar nga blerësi (shitjet në tregjet tjera). Me gjithë mungesën e kompanive të transportit, kjo nuk

paraqet problem për shkak të afërsisë së blerësve si dhe pranisë së një numri të madh të kompanive të transportit nga Serbia.

3.10 Kompanitë e marketingut

Si në jug ashtu edhe në veri të Mitrovicës bëhet shumë pak apo nuk bëhet fare promovim i produkteve. Shërbimet e kompanive të marketingut kërkohen nga akterët vetëm gjatë aktiviteteve promovuese apo pjesëmarrjes në panaire apo për shërbimet e dizajnit të etiketimit dhe materialit ambalazhues të produkteve finale që shiten në tregun vendor.

3.11 Certifikimet

Në Kosovë nuk ka organ të akredituar për certifikim; rrjedhimisht për shërbime të certifikimit kontrahohen organe nga shtetet fqinje. "Albinspect" nga Shqipëria ofron shërbime të tilla për certifikime organike, ndërkaq për HACCP ekzistojnë një numër ofruesish. Përderisa certifikimi organik paguhet nga kompanitë, shumica e përgatitjeve për certifikim HACCP përkrahen nga donatorët. Agroproduct ka pasur certifikimin organik për së paku 5-7 vjet. Kompania certifikon zonat e mbledhjes dhe të kultivimit në Mitrovicë. Në Mitrovicën e Veriut nuk ka ndonjë agjenci vendore certifikimi për certifikimin e produkteve dhe/ose standardeve në fushën e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001, siguria e produkteve H14001). Bazuar në intervista, ekziston një nivel shumë i ulët i informimit lidhur me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Sistemi i sigurisë së ushqimit (HACCP- i cili është bazë për të gjitha standardet e sigurisë së ushqimit) është implementuar vetëm nga një kompani në "ZZ Zubin Potok".

3.12 Edukimi

Në institucionet që ofrojnë edukimin përkatës për fuqinë punëtore në Mitrovicën e Jugut përfshihen Departamenti i Botanikës i Fakultetit të Matematikës dhe Shkencave Natyrore të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Teknologjisë ofron ligjëratat në degën e teknologjisë ushqimore dhe shkollat e mesme profesionale të bujqësisë. Sidoqoftë, këto institucione nuk zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për tregun e punës. Aktualisht, përkrahje tjetër për këtë nën-sektor është ofruar nga projektet zhvillimore përmes trajnimeve, vizitave studimore, shtypjes së materialit teknik dhe këshillimeve në fermë.

Në Mitrovicën e Veriut ekzistojnë tri institucione që mbulojnë fushën e teknologjisë ushqimore dhe bujqësisë. Këto janë Shkolla e Bujqësisë në Leshak¹¹, Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë¹² si dhe Fakulteti i Teknologjisë i themeluar së fundmi.

11 <http://www.poljoprivrednaskolapristinalesak.edu.rs/>

12 <http://www.agr.pr.ac.rs/>

4. KARAKTERISTIKAT E KËRKESËS DHE OFERTËS

4.1 Gjendja në Mitrovicën e Jugut

Produktet PPJD të mbledhura në komunat Mitrovicë, Vushtrri dhe Skënderaj janë kërpudhat, aguliçet, shtogu, mollët e egra dhe hithrat. Bimët mjekësore dhe aromatike kultivohen në bashkëpunim edhe me përpunuesin Agroproduct nga Istogu ku mëllaga kultivohet në 4 ha, menta në 1.5 ha dhe sherbelja në 1.5 ha.

Tabela 1 më poshtë paraqet shembullin e strukturës së shpenzimeve për disa lloje të PPJD-ve, duke përfshirë sasinë e përgjithshme të mbledhur nga qendrat e grumbullimit, të hyrat ditore të mbledhësve dhe numrin e ditëve të shpenzuara për mbledhje të llojeve të ndryshme. Ky shembull tregon se llojet e ndryshme kanë shpenzime të ndryshme dhe të hyra të ndryshme; sidoqoftë, këto shpenzime mund të ndryshojnë për shumë arsye, p.sh. moti i mirë rritë prodhimtarinë pasi që frutat pas vjeljes mund të thahen më lehtë. Tabela e mëposhtme tregon funksionet në qendrën grumbulluese me fitimet e përkohshme nga ato funksione. Çmimet dhe sasinë e mbledhura janë dhënë në sasinë minimale që duhet të organizohen nga një qendër grumbullimi. Ditët e përfshira të punës janë përaftrim i punës së nevojshme për gjysmë-përpunimin e disa prej produkteve të mbledhura.

Tabela 1 - Shpenzimet e mbledhjes

Llojet	Sasia e mbledhur – e tharë (kg)	Paguar nga qendrat e grumbullimit-të freskëta (€/kg)	Sasia ditore e mbledhur-të freskëta (kg/day)	Nr. i përgjithshëm i ditëve të punës	Të hyrat ditore (€/day)	Të hyrat e përgjithshme të mbledhësve (€)
Aguliçe ¹³	5.000	0,83	12	417	10	2.500
Tilia cordata	1.000	1,67	9	111	15	5.000
Sambucus nigra	5.000	0,75	20	250	15	2.250
Vaccinium myrtillus	2.000	1,6	20	100	32	4.800
Juniper communis	12.000	0,32	50	240	16	9.600
Rosa canina fructus	8.000	0,5	50	160	25	1.500
Malus sylvestris	12.000	0,1	150	80	15	300

Tabela 2 më poshtë tregon shpenzimet e përafërta dhe të hyrat bruto të qendrave të grumbullimit. Kjo mund të ndryshojë prapë për shumë arsye; veçanërisht të hyrat e përpunuesve pasi që blerësit në tregjet e eksportit paguajnë pasi të jenë bërë analizat e produktit dhe në rast se cilësia e produk-

13 Në original: *Primula Veris*

tit është më e ulët se ajo e kontraktuar, ata do të paguajnë më pak, gjë që nganjëherë bën që shumica e paguar të jetë më e ulët se çmimi i paguar nga përpunuesi për të blerë produktin. Çmimet ndryshojnë çdo vit dhe varen kryesisht nga sezoni, por marzhat ndërmjet mbledhësve, përpunuesve dhe qendrave të grumbullimit janë zakonisht fikse.

Tablela2 - Shpenzimet e funksioneve të përpunuesve

Llojet	Sasia e mbledhur – e tharë (kg)	Çmimi i paguar nga përpunuesi të thara (€/kg)	Çmimi i shitjes (€)	Shpenzimet e përgjithshme (€)	Të hyrat e përgjithshme (€)	Marzha
Primula veris	5.000	5,00	6,50	25.000	32.500	30%
Tilia cordata	1.000	5,00	6,00	5.000	6.000	20%
Sambucus nigra	8.000	4,50	5,50	36.000	44.000	22%
Vaccinium myrtillus	2.000	13,20	16,50	26.400	33.000	25%
Juniper communis	12.000	0,80	1,00	9.600	12.000	25%
Rosa canina fructus	16.500	0,40	0,50	6.600	8.250	25%
Malus sylvestris	31.000	0,60	0,80	18.600	24.800	33%

4.2 Gjendja në Mitrovicën e Veriut

Siç është treguar në Tabelat 3 dhe 4 më poshtë, frutat pyjore (boronicat, manaferrat e egra, dredhëzat e egra), si dhe kërpudhat e egra (kantarela, kërpudhat e ujkut, morelat e vërteta) mbledhen në Mitrovicën e Veriut, ndërsa BMA-të mbledhen për qëllime private të mbledhësve apo/dhe shiten në tregun vendor në mënyrë sporadike . Përveç kësaj mbledhen edhe sasi të vogla të mollëve të egra (ato shiten ekskluzivisht në Serbi), si dhe kaçat të cilat më parë mbulonin një pjesë të rëndësishme të tregut. Të gjitha produktet nga më lartë (përveç mollëve dhe kaçave) përpunohen duke i tharë dhe/apo ngrirë. Sasi më të vogla shiten si produkte të freskëta (të ftohura) në Serbi.

Të hyrat e realizuara përmes mbledhjes mund të definojnë si shtesa të burimit kryesor të të hyrave, edhe pse një familje (dy anëtarë të përfshirë në mbledhje) mund të fitojnë 4,000-4,500 €¹⁴ në vit, që paraqet rreth 330-375 € të hyra neto në muaj. Sidoqoftë, duke mbledhur lloje më të shtrenjta të PPJD-ve (siç janë boronicat), të hyrat mund të kalojnë vlerën prej 7,000 € për një sezon (sezoni i mbledhjes së boronicës zgjatë rreth një muaj).

14 Të dhënat e marra përmes intervistave.

Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e shpenzimeve të disa llojeve të PPJD-ve, duke përfshirë sasinë e përgjithshme të mbledhur nga qendrat e grumbullimit në rajonin e Mitrovicës së Veriut dhe disa të dhëna tjera relevante.

Sasia e përgjithshme e PPJD-ve të mbledhura nuk mund të përcaktohet saktë pasi që nuk ka të dhëna specifike për rajone të mbledhjes, por bazuar në intervistat e mbajtura, vlerësohet se është ndërmjet 950 dhe 1250 ton.¹⁵

Fermerët që vendosin të kultivojnë lloje të egra si dredhëzat e egra, mjedrat apo manaferrat mund të llogarisin në të hyra prej 2,400 deri 3,500 € të realizuara nga 0.1 ha plantacion; rrjedhimisht, mund të konkludohet se nga një sipërfaqe mesatare prej 0.30 ha-0.40 ha, të hyrat e përgjithshme mund të arrijnë ndërmjet 7,200 dhe 13,500 €.

Tabela 3 - Shpenzimet e mbledhjes - Mitrovica e Veriut

Lloji	Sasia e mbledhur – e freskët (kg)	Paguar nga qendrat e grumbullimit- (€/kg)	Sasia ditore e mbledhur- të freskëta (kg/day)	Nr. i përgjithshëm i ditëve të punës	Të hyrat ditore (€/day)	Të hyrat e përgjithshme të mbledhësve (€)
(Chanterelle) Cantharellus cibarius	90.000	2.2-4.3	3	120	6,6-12,9	1.500
Boletus edulis (cep, penny bun, porcino, apo king bolete, zakonisht quhen porcini);	180.000	1.5-2.5	5.5	120	8,25-13,75	1.200
Morela e vërtetë e freskët	Nuk është në dispozicion por >100.000	3.5	5	120	14	2.000
Morela e vërtetë e tharë	Nuk është në dispozicion (nuk janë sasi të konsiderueshme)	100	N/A	N/A	N/A	N/A
Dredhëzat e egra (Fragaria vesca)	Nuk është në dispozicion por >8 .000	4.5-5.5	3	40	13,5-16,5	600
Manaferra e egër (Rubus fruticosus)	Nuk është në dispozicion por >100.000	0.8	12	40	9,6	300
Boronica (Vaccinium myrtillus)	215.000	1.25-2	8-10	60	10-20	900
Dëllinja e zakonshme Juniperus communis	160.000	0.7-1.0	50	N/A	16	N/A

¹⁵ Ibid.

Kaça (Rosa canina)	Nuk është në dispozicion	0,50	30	90	15	1.000
Molla e egër	10.000	0,09-0,13	100	30	9-13	N/A
Mjedrat e kultivuara (shiten në tregun vendorë)	100.000	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Frutat tjera (manaferra, mollët, etj.) dhe speciet tjera të egra të papërmendura më lartë	290.000	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Tabela 4 më poshtë tregon shpenzimet e përafërta dhe të hyrat bruto të qendrave grumbulluese. Të hyrat e tyre varen nga gjendja në tregun ndërkombëtar.

Kapaciteti i tregut ndërkombëtar është i madh, gjë që paraqet mundësi shumë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të mbledhjes. Pritet që tregu i BE-së, që në përgjithësi është destinacioni final për produktet nga ky rajon, do të vazhdojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme deri në vitin 2019.

Tabela 4 - Shpenzimet funksionale të përpunuesve –Mitrovica e Veriut

Llojet	Sasia e mbledhur – (kg)	Çmimi i paguar nga përpunuesi të thara (€/kg)	Çmimi i shitjes (€)	Shpenzimet e përgjithshme (€)	Të hyrat e përgjithshme (€)	Marzha %
(Chanterelle) Cantharellus cibarius	90.000	2.2-4.3	2.6-5.6	198.000-387.000	234.000-504.000	18-30
Boletus edulis (cep, penny bun, porcino, apo king bolete, zakonisht quhen porcini);	180.000	1.5-2.5	1.5-3.2	270.000-450.000	270.000-576.000	28
Morela e vërtetë e freskët	Nuk është në dispozicion. por >100.000	3.5	5.0-6.0	350.000	500.000-600.000	42-71
Morela e vërtetë e tharë	Nuk është në dispozicion (nuk janë sasi të konsiderueshme)	100	120-140	N/A	N/A	20-40
Dredhëzat e egra (Fragaria vesca)	Nuk është në dispozicion. por >8.000	4.5-5.5	5.4-7.1	36.000-44.000	43.200-56.800	20-30
Manaferra e egër (Rubus fruticosus)	Nuk është në dispozicion. por >100.000	0.8	0.95-1.05	80.000	95.000-105.000	18-31

Boronica (Vaccinium myrtillus)	215.000	1.25-2	1.5-2.6	268.750-430.000	322.500-559.000	20-30
Dëllinja e zakonshme Juniperus communis	160.000	0.7-1.0	0.85-1.3	112.000-160.000	136.000-208.000	21-30
Kaça (Rosa canina)	Nuk është në dispozicion	0,50	0,6-0,65	N/A	N/A	20-30
Molla e egër	10.000	0,09-0,13	0,1-0,17	900-1300	1000-1700	11-31
Mjedrat e kultivuara (shiten në tregjet vendore)	100.000	N/A	2	N/A	N/A	N/A
Frutat tjera (manaferra, mollët, etj.) dhe speciet tjera të egra të papërmendura më lartë	290.000	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Bazuar në intervista, karakteristikë kryesore e blerësve/përpunuesve vendor është se gati e gjithë sasia shitet përmes eksportuesve kryesor në Serbi; për këtë arsye çmimet janë më të ulëta se sa do të ishin sikur të eksportohehin drejtpërdrejt për në BE. Sidoqoftë, meqenëse mallrat janë kryesisht të tilla që duhet përpunuar tutje (mungesa e pajisjeve përpunuese në rajon), fitimi i gjeneruar nga blerësit/përpunuesit është 20% (në depon e tyre) deri në 30% ("e shpërndarë falas" tek depoja e blerësit). Përpunuesit e intervistuar nuk kanë llogaritur ende shpenzimet e përpunimit për kilogram, prandaj këto të dhëna nuk janë në dispozicion. Megjithatë, bazuar në llojin e prodhimit, faktorët kryesorë në shpenzimet e prodhimit janë shpenzimet e fuqisë punëtore dhe shpenzimet e energjisë. Investimet për mirëmbajtjen e infrastrukturës gjithashtu i duhen shtuar këtyre shpenzimeve. Përpunimi i produkteve të ngrira bëhet vetëm në fabrikën "AS Promet", që do të thotë më shumë investime si dhe çmime më të larta të produktit final kur futet në rrjetet e shitjes me pakicë. Për më tepër, instalimi i pajisjeve për ambalazhim të vogël komercial mund të rrisë edhe më shumë çmimin e produktit.

Çmimet e shitjes të përcaktuara kundrejt kompanive në Serbi janë në nivel me çmimet mesatare në rajon. Për më tepër, çmimet e caktuara nga kompanitë serbe në tregun ndërkombëtar varen ekskluzivisht nga trendet në tregjet ndërkombëtare dhe janë të kushtëzuara nga lloji dhe cilësia e mallrave, sasia e ngarkesës, periudha e kontraktuar, vet kontrata, si dhe nga origjina e mallrave, destinacioni i shitjes dhe parametra të tjerë. Prapë se prapë, në përgjithësi mund të thuhet se marzha mesatare e realizuar nga eksportuesit serb në BE dhe Rusi është në nivel prej 10%-20%, që do të thotë se ka një dallim prej 45% deri në 60% ndërmjet çmimit të mbledhjes dhe çmimit me të cilin produktet shiten në tregun ndërkombëtar.

5. TREGTIA VENDORE DHE E JASHTME DHE TRENDET E TREGUT – PIKAT HYRËSE TË TREGUT DHE KONKURRENCA

Kërkesa për produkte PPJD është e lartë në mbarë botën. Eksportuesit kosovarë më së shumti eksportojnë për në Gjermani si tregu i tyre më i madh, në Itali – kryesisht kërpudha dhe në shtetet tjera të BE-së. Këto produkte shiten si material i papërpunuar tek përpunuesit më të mëdhenj të ushqimit, tek industria farmaceutike dhe ajo kozmetike. Kërkesa ka trend në rritje – veçanërisht industria ushqimore është me kërkesë në rritje të artikujve të shëndetshëm ushqimor, ndërkaq industria farmaceutike është në kërkim të më shumë përbërësve bimorë. Sidoqoftë, paralelisht me kërkesën në rritje të produkteve të caktuara, ekzistojnë kritere të ashpra sa i përket cilësisë të kërkuara nga përpunuesit. Ekziston gjithashtu një rritje në kërkesën për produkte organike, që për përpunuesit kosovarë paraqet problem në përmbushjen e kërkesave të klientëve. Megjithatë, më përmirësimin e standardeve të cilësisë, Kosova do të hapë rrugët e saj drejt tregut të BE-së.

Furnizimi me PPJD në tregun rajonal dominohet nga Serbia, që pasohet nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Lëndët e para kryesisht u shiten përpunuesve apo eksportuesve. Kjo ka rezultuar në një bilanc tregtar pozitiv për PPJD, gjë që është e rrallë për Kosovën. Sipas të dhënave nga Eurostat-i, në vitin 2014 Kosova ka eksportuar 1,255 tonelata PPJD në vlerë prej 3.8 milion €. Në të njëjtin vit, ajo ka importuar 282 tonelata në vlerë prej 0.95 milion €. Megjithatë, duke marrë në konsideratë problemet me grumbullim të dhënash, gjatë prezantimit të të gjeturave tek akterët e nën-sektorit, është konkluduar se vlera e eksporteve është shumë më e lartë, kryesisht për shkak të dy arsyeve – sasi të mëdha të PPJD-ve eksportohen për në Serbi përmes kanaleve ilegale dhe produktet paraqiten me “Kode Harmonizimi” të ndryshuara në dogana prandaj është e vështirë të sigurohen të dhëna statistikore zyrtare. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat nga Eurostat-i.

Tabela 5 - Vlera mujore e eksporteve dhe importeve të PPJD-ve¹⁶

2014	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
	68.730	79.596	80.917	45.031	85.505	104.201	61.056
Importi mujor	M8	M9	M10	M11	M12	Gjithsej	Bilanci
	82.201	142.806	202.936	-	-	525.036	
Eksporti mujor	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
	227.294	285.595	59.712	50.156	224.307	341.307	267.203
	M8	M9	M10	M11	M12	Gjithsej	Bilanci
	479.742	1.221.925	639.349	-	-	1.455.574	930.538 ¹⁷

¹⁶ Tabela 4 dhe 5 paraqesin aspektin sezonal të eksportit dhe importit duke dëshmuar orientimin kah eksporti të sektorit të PPJD-ve

¹⁷ Agjencia Doganore e Kosovës

Tabela 6 - Sasia mujore e eksporteve dhe importeve të PPJD-ve

2014	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
Importi mujor	27	33	15	12	17	43	14
	M8	M9	M10	M11	M12	Gjithsej	Bilanci
	63	35	33	-	-	162	
Eksporti mujor	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
	65	72	23	33	37	74	45
	M8	M9	M10	M11	M12	Gjithsej	Bilanci
	146	425	335	-	-	906	745 ¹⁸

Kur informatat e nxjerra nga intervistat me palët e interesit krahasohen me të dhënat zyrtare nga doganat të paraqitura në tabelën 5 dhe 6, mendohet se shifrat zyrtare paraqesin vlerë më të ulët të eksportit. Vlera e prezantuar për eksporte të produkteve është zakonisht më e ulët sesa çmimi faktik i materialit për shkak të qëllimeve të taksimit. Kultivimi ka trend në rritje – kjo është si rezultat i nënshkrimit të kontratave afatgjatë të furnizimit nga një përpunues me blerës të mëdhenj nga Gjermania dhe Austria.

Tabela 7 - Tregjet më të mëdha për eksport dhe import të PPJD-ve

PRODUKTI ¹⁹	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Prodhimtaria (t)	1.650	2.040	2.460	2.860	3.050	3.850
Sipërfaqja e kultivuar (ha)	12	30	40	75	175	250
Të kultivuara (t)	35	95	125	235	540	820
Të mbledhura (t)	1.615	1.945	2.335	2.625	2.510	3.030
Gjithsej eksport (t)	1.562	1.887	2.241	2.571	2.629	3.240
Vlera e eksportit (euro)	2.100.000	2.650.000	3.150.000	3.750.000	4.167.000	5.200.000
Vendet importuese 5 të parat (% e importit të përgjithshëm)	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda
Vendet eksportuese 5 të parat (% e eksportit të përgjithshëm)	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda	Serbia, Gjermania, Italia, Zvicra, Holanda

18 Ibid

19 Ibid

6. LIDHJET HORIZONTALE DHE VERTIKALE

6.1 Lidhjet horizontale

<p>Gjetjet e përgjithshme</p>	<p>Lidhjet vertikale në sektorin e PPJD-ve mund të shërbejnë si një shembull për të gjithë sektorët bujqësor jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet tjera gjithashtu. Modelet ekzistuese të integritit vertikal në këtë sektor mund të njihen si promotori kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të këtij zinxhiri të vlerave në periudhën e kaluar. Është e pamundshme të shihet ky proces vetëm nga këndvështrimi vendor. Zhvillimet pozitive apo negative në rajon ndikojnë drejtpërdrejt në prodhimtari në Mitrovicë.</p> <p>Lidhjet horizontale, në anën tjetër, janë ende një sfidë. Ndërmarrjet e vogla dhe ndikimi negativ që organizimi i kooperativave gjatë periudhës socialiste kishte në ekonomi, nuk ndikojnë drejt krijimit të lidhjeve të natyrshme horizontale. Ky proces duhet mbështetur me masa të përshtatshme institucionale financiare të subvencionimit.</p>
<p>Mitrovica e Jugut</p>	<p>Viteve të fundit, akterët kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme si punëtori, prezantime dhe panairë vendore e ndërkombëtare, kryesisht të organizuara e të mbështetura nga projektet donatore. Përmes kontakteve të rregullta, akterët kanë filluar të bashkëpunojnë shumë më mirë duke shkëmbyer informata dhe duke debatuar për çështje të ndryshme. Për më tepër, vitin e kaluar, përpunuesit dhe eksportuesit kanë themeluar shoqatën e quajtur "Organika" e cila ka për synim zhvillimin e nën-sektorit, përmes promovimit të produkteve me certifikim organik dhe përmes rritjes së investimeve e bashkëpunimit të palëve të interesit. Aktualisht, shoqata është duke organizuar prezantimin e produkteve të tyre organike në panairin BioFach në Nuremberg, Gjermani, që është panairi më i madh për produkte organike. Pjesëmarrja në këtë panair bashkëfinancohet nga GLZ-i dhe vet pjesëmarrësit. Nuk ka bashkëpunim apo shoqatë të akterëve të tjerë për të përmirësuar lidhjet horizontale.</p>
<p>Mitrovica e Veriut</p>	<p>Në territorin e synuar, ekziston vetëm një kooperativë bujqësore në komunën e Zubin Potokut, por kjo kooperativë është e strukturuar dhe e zhvilluar si kompani, prandaj nuk mund ta identifikojmë atë si kooperativë. Ekzistojnë ide që të themelohet kooperativa në Mitrovicën e Veriut, por ende nuk janë ndërmarrë hapa konkret.</p> <p>Përpunuesit bashkëpunojnë (nganjëherë ata i tregtojnë me njëri tjetrin produktet e blera apo bëjnë strategji se cili do të blejë cilat produkte në rajon), por bashkëpunimi është i rastësishëm dhe joformal. Nga intervistat shihet se bashkëpunimi është i mundshëm me ndërmjetësim të jashtëm pasi që palët e përfshira janë në dijeni për përfitimet nga shoqata (grupi) e mbledhësve, përpunuesve dhe palëve tjera relevante.</p> <p>Kompanitë nga Serbia gjithashtu do të dëshironin që të merrnin pjesë e të bëheshin anëtarë të shoqatës dhe/apo grupit i cili do të lidhte të gjitha palët e interesit në rajon duke u bazuar në interesin e tyre ekonomik.</p>

6.2 Lidhjet vertikale

<p>Mitrovica e Jugut</p>	<p>Lidhjet vertikale janë mjaft të zhvilluara dhe rrjedha e informatave është e lehtë. Si rezultat i qasjes së përmirësuar në tregjet e eksportit, përpunuesit kanë zhvilluar lidhjet me qendrat e grumbullimit dhe mbledhjes mjaft shpejtë. Zinxhiri i vlerave është plotësisht i integruar: përpunuesit tashmë kanë bërë shumicën e investimeve dhe po marrin shumicën e rrezikut duke financuar paraprakisht të gjitha aktivitetet operuese, duke përfshirë mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin bazë. Shumica e tyre blejnë produkte para se të kenë siguruar tregun, gjë që sipas tyre i ekspozon ata në rreziqe të konsiderueshme, por është mënyra e vetme për të mbajtur në zhvillim nën-sektorin.</p> <p>Një shembull i mirë i lidhjeve të përmirësuara vertikale është kompania Agroproduct nga Istogu, e cila operon në rajonin e Mitrovicës. Kjo kompani ofron material për mbjellje, fidanë dhe këshillim në fermë për fermerët që ata të kultivojnë BMA, duke iu garantuar atyre blerjen e të gjithë rendimentit – ky është një shembull ideal i modelit të organizuar të integritit vertikal të prodhimit. Në të njëjtën kohë, duke zbatuar kërkesat e certifikimit organik, kompania nënshkruan kontrata me qendrat e grumbullimit për furnizimin me produktet e mbledhura PPJD të egra. Ky model është i rrallë në të gjithë rajonin e Ballkanit dhe ka ndihmuar në zhvillimin e të gjithë zinxhirit të vlerave – është model që duhet kopjuar.</p> <p>Përpunuesit kryesorë kosovarë transferojnë informatat për sasi, çmimet dhe kushtet e kërkuara për cilësi tek qendrat e grumbullimit dhe përmes tyre deri tek mbledhësit. Përveç kësaj, ata ofrojnë informata teknike lidhur me përshkrimin e llojeve, kalendarin e vjeljes, llojet e bimëve që duhen mbledhur dhe trajtimin pas vjeljes, me përkrahjen e projekteve zhvillimore, por kohëve të fundit, edhe duke shpërndarë udhëzuesit dhe broshurat e tyre tek qendrat e grumbullimit dhe mbledhësit.</p>
<p>Mitrovica e Veriut</p>	<p>Duket se nuk ka shoqata (formale) apo shoqëri të bashkuara të bizneseve ndërmjet blerësve/përpunuesve. Qarkullimi i mallrave në tregun rajonal është i organizuar mirë dhe zakonisht bazohet në çmimin e ofruar nga shitësit e mëdhenj me shumicë. Gjatë kulmit të sezonit, çmimi i PPJD-ve luhet në baza ditore, kështu që lidhjet e krijuara me shitësit më të mëdhenj rajonal me shumicë gjithmonë konsiderohen si përparësi e madhe në këtë biznes. Marrëdhëniet binzesore ndërmjet akterëve priren të jenë joformale, të bazuara në mirëbesim dhe bashkëpunim të qëndrueshëm afatgjatë, e jo të bazuara në kontrata. Sidoqoftë, rëndësia e kontraktimit duket se është duke u kuptuar nga bizneset në sektorin e PPJD-ve, posaçërisht tek blerësit më të mëdhenj që duan të sigurojnë mallrat paraprakisht dhe të jenë më konkurrues në aspektin e sasive të planifikuara.</p>

7. ÇËSHTJET KYÇE TË IDENTIFIKUARA NË RAJONIN E SYNUAR

7.1 Përparësitë

- Sektori është tërësisht i orientuar kah eksporti - 80-90% e prodhimit të përgjithshëm në zinxhirin e vlerave eksportohet kryesisht në Serbi, Gjermani, Itali, Zvicër, dhe Holandë²⁰.
- Ka një llojllojshmëri të madhe të BMA-ve dhe frutave të imëta që mund të mblidhen në zonën e synuar – ka potencial për rritje të mbledhjes së frutave të imëta dhe BMA-ve. BMA-të aktualisht nuk mblidhen në Mitrovicën e Veriut.
- Afërsia ndaj tregjeve të mëdha
- Tradita në mbledhjen e PPJD-ve
- Integrimi ekzistues vertikal me rrjetin e kultivuesve, qendrave të grumbullimit dhe afërsia e zonave të mbledhjes – Kompania Agroprodukt nga Istogu është qendra më e madhe blerëse me çmim të garantuar, me më shumë se 40 qendra grumbullimi, 3,250 nënkontraktues²¹, një numër të kultivuesve të kontraktuar, prodhimin vetanak të fidanëve për mbjellje dhe sistem të zhvilluar të shërbimeve të zgjeruara (vlen kryesisht për Mitrovicën e Jugut me potencial të kopjimit edhe në Mitrovicën e Veriut).
- Investimet e konsiderueshme në sektor – Përpunimi i BMA-ve, prodhimi i materialit fidanor të BMA-ve, masat moderne të mbrojtjes së bimëve, kthimi në kultivim (kryesisht në Mitrovicën e Jugut).
- Fushat që kultivohen janë në rritje – raporti aktual mbledhje/kultivim është 70% me 30% në favor të mbledhjes, por me investimet në rritje në pjesën e kultivimit.²²

7.2 Dobësitë

- Qasja në kapital – Kreditë investive të shtrenjta (Mitrovica e Jugut) apo mos qasja në kredi (Mitrovica e Veriut).
- Mungesa e informatave tek palët e interesit të zinxhirit të vlerave në veri dhe në jug – Akterët e të njëjtit zinxhir të vlerave kanë informata të ndryshme apo nuk kanë fare informata lidhur me zhvillimin e sektorit. Rrjedha e informatave është veçanërisht e ulët ndërmjet Veriut dhe Jugut të Mitrovicës.
- Infrastruktura e dobët rrugore – zvogëlon cilësinë gjatë transportit të frutave të imëta të mbledhura apo të kultivuara
- Mungesa e shërbimeve të qëndrueshëm-këshillimore – Struktura aktuale e mbështetjes e ofruar nga IADK-ja varet nga ndihma e donatorëve. Modeli i integritit të Agroproduktit ofron disa shërbime, por vetëm për fermerët që kanë kontratë të nënshkruar me të. Aktualisht nuk ka sistem institucional funksional për shërbime këshillimore.
- Numri i kufizuar i kompanive aktive në sektor – një numër i vogël në rajon i depove më të mëdha për ftohje me kapacitete për të ofruar funksione pas vjeljes.

20 Agjencia Doganore e Kosovës

21 Intervistat në terren

22 Diskutimet në grupet e fokusit

- Lidhjet e dobëta ndërmjet institucioneve arsimore, institucioneve kontrolluese dhe kompanive – nuk ka bashkëpunim formal ndërmjet NVM-ve dhe programeve universitare, gjë që kufizon potencialin për futjen e teknologjive të reja të prodhimit.
- Numri i kufizuar i kultivuesve dhe madhësia relativisht e vogël e fermave – Kultivimi i frutave të imëta dhe BMA-ve është aktivitet relativisht i ri që aplikohet në hapësira të vogla demonstruese, me madhësi mesatare prej 0.1 ha dhe numri i vogël i fermave të përfshira në proces.
- Ndërprerja e traditës së mbledhjes së PPJD-ve në Mitrovicën e Veriut dhe njohuritë e kufizuara lidhur me procesin e mbledhjes dhe biodiversitetin ekzistues në rajon – programet e strukturuar të trajnimit nuk janë në dispozicion për mbledhësit, që rezultojnë në zvogëlim të aktiviteteve të mbledhjes. BMA-të nuk mblidhen fare në Mitrovicën e Veriut për shkak të mungesës së njohurive të mbledhësve dhe mungesës së lidhjeve me blerësit potencial.
- Fokusi në produkte me vlerë të ulët të shtuar. Produktet nga ky sektor përdoren kryesisht si lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm, rrallëherë përfshijnë përpunimin vendor.
- Numri i kufizuar i granteve nga MBPZHR-ja për të përkrahur zhvillimin e sektorit të agrobiznesit – MBPZHR-ja paguan subvencione për fermerët dhe prodhuesit, por me përkrahje të kufizuar për Zinxhirin e synuar të vlerave. Fermerët në Mitrovicën e Veriut aktualisht nuk marrin përkrahje nga MBPZHR-ja.
- Numri i kufizuar i kompanive të certifikuar për prodhim organik.
- Mungesa e mekanizmave për siguri të ushqimit (Mitrovica e Veriut).
- Mungesa e pajisjeve të përshtatshme për trajtimin e produkteve pas vjeljes.

7.3 Mundësitë

- Kërkesa e rritur në mbarë botën për këto produkte.
- Kërkesa në rritje në mbarë botën për ushqim dhe pije organike dhe tregu global i frutave të imëta – sipas të dhënave të fundit në dispozicion nga raportet nga e mbarë bota, është vënë në dukje se shkalla e rritjes vjetore e ushqimit dhe pijeve organike në tregun global është +12.8%.
- Sistemi ekzistues i prodhimit vendor të fidaneve për BMA për kultivuesit vendor (Mitrovica e Jugut).
- Fuqia punëtore me shpenzime të ulëta – Paga mesatare bruto në Kosovë është 372EUR²³
- Regjimi i tregtisë së lirë – qasja në tregjet e BE-së – Kosova është anëtar i Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) që rezultojnë në qasje të lirë në tregun rajonal dhe por ende jo në funksion regjim jo-reciprok i tregtimit me vendet e BE-së.
- Politika të favorshme tatimore – Kosova ka sistemin tatimor me tarifa fikse që është i thjeshtë dhe zvogëlon barrën tatimore për individët dhe bizneset.
- Kërkesat për sasi të mëdha në tregjet e eksportit dhe procesi konkurrues – partnerët importues nënshkruajnë kontrata 3-5 vjeçare me eksportuesin, ku garantojnë sasi dhe çmimet.
- Fillimi i prodhimit të vajit esencial nga BMA-të e ndryshme në Mitrovicën e Veriut – Mund të nisë mbledhjen dhe kultivimin e BMA-ve në këtë rajon.

23 <http://hdr.undp.org/sites/default/files/khdr2014english.pdf>

7.4 Rreziqet

- Mjedisi biznesor – Korniza ligjore që aktualisht nuk ofron mekanizma monitorues, praktika të qëndrueshme të mbledhjes, licenca për mbledhje apo kuota që duhet të sigurojnë mbrojtjen e biodiversitetit në rajon.
- Shpyllëzimi dhe mbledhja e pakontrolluar që rezultojnë në shkatërrimin e biodiversitetit.
- Ndryshimet klimatike – që ndikojnë në mënyrë drastike në disponueshmërinë e produkteve dhe potencialisht zvogëlon mbledhjen.
- Migrimi nga zonat rurale në ato urbane dhe migrimi i të rinjve nga viset malore – zvogëlon numrin e njerëzve që do të mund të ishin aktiv edhe në kultivim edhe në aktivitetet mbledhëse në këtë sektor.
- Rifillimi i funksionimit të Trepçës – ndotja e mjedisit dhe zvogëlimi i cilësisë së produkteve të mbledhura.

8. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SEKTORIT

8.1 Çështjet rreth përmirësimit të mjedisit biznesor

8.1.1 Çështja

Themelimi i mekanizmave për menaxhim, monitorim dhe kontroll të qëndrueshëm të burimeve natyrore pyjore.

Përfundimet

Nuk kanë mundur të identifikohen çfarëdo lloj mekanizma kontrollues për praktikat aktuale të mbledhjes, licencat për mbledhësit, lejet për themelimin e qendrave të grumbullimit apo kuotat mbrojtëse të mbledhjes për disa BMA të rrezikuara. Para vitit 2009, projekti për planifikimin dhe vendosjen në hartë të zonave që kanë të bëjnë me disponueshmërinë dhe shpërndarjen e produkteve PPJD në Kosovë është iniciuar dhe përkrahur. Edhe pse i detajuar jo-mjaftueshmërisht dhe nuk mbulonte territorin e Mitrovicës së Veriut, ky proces ka vënë themelin për zhvillimin e mekanizmave të duhur kontrollues dhe për zhvillimin e kuotave për produkte të caktuara që konsiderohen si lloje të rrezikuara.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja e **procesit të vendosjes në hartë të PPJD-ve** në rajonin e synuar, në koordinim me organizatat tjera relevante në bashkëpunim të drejtpërdrejt me OJQ-të aktive në rajon. Ky proces duhet të organizohet në koordinim me institucionet vendore dhe universitetet ekzistuese në rajonin e Mitrovicës që do të sigurojë pronësi të rezultateve të arritura.
- Lehtësimi i procesit të **zhvillimit të kornizës së duhur ligjore** që do të rezultonte në zhvillimin e mekanizmave monitorues dhe kontrollues në harmoni me Strategjinë Kombëtare për PPJD. Ky proces duhet të udhëhiqet nga institucionet relevante qendrore, por në të njëjtën kohë duhet të sigurojë pjesëmarrje aktive të NVM-ve, institucioneve vendore dhe organizatave publike. Korniza e re ligjore duhet të marrë në konsideratë krijimin e licencimit të mbledhjes, krijimin e rregullave për funksionimin dhe menaxhimin e qendrave të grumbullimit, rregulloren për përpunuesit dhe kontratat ndërmjet mbledhësve dhe përpunuesve, caktimin e kuotave për mbledhje dhe trajnimin e obligueshëm për mbledhësit.

8.1.2 Çështja

Sigurimi i qarkullimit më të mirë të informatave në zinxhirin e vlerave, e cila do të ofronte përdorim më të mirë të burimeve në dispozicion dhe bashkëpunim të përmirësuar ndërmjet NVM-ve në veri dhe atyre në jug të Mitrovicës.

Përfundimet

Aktualisht ka shumë donatorë dhe institucione që përkrahin këtë sektor. Perceptimi mbizotërues është që shpesh këto aktivitete ndeshen me njëra tjetrën pa i avancuar rezultatet e njëra tjetrës. Strategjia Kombëtare për PPJD-të 2014-2020 ofron disa drejtime për koordinimin e të gjitha strukturave mbështetëse, duke tentuar që të përcaktojë rolet e tyre në sistem. Të gjitha palët vendore të interesit, varësisht nga roli i tyre në sistem, duhet të bëjnë përpjekje që të harmonizojnë aktivitetet e tyre me strategjinë kombëtare të aprovuar.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja e zhvillimit të **strategjisë afatmesme për zhvillimin e sektorit të PPJD-ve në një komunë nga rajoni i synuar** që është në harmoni me Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e sektorit të PPJD-ve. Kjo strategji duhet të marrë në konsideratë pjesëmarrjen e të gjitha palëve vendore relevante të interesit, duhet të përcaktojë rolin e komunës në zhvillimet e ardhshme në sektorin e PPJD-ve dhe duhet të shërbejë si shembull për komunat tjera në rajonin e synuar.

8.1.3 Çështja

Përmirësimi i pasqyrimin të të gjitha palëve relevante të interesit në rajonin e Mitrovicës.

Përfundimet

Nuk ka mundur të identifikohet asnjë regjistër formal i kompanive aktive në rajonin e Mitrovicës. Ky problem bie në pah edhe më shumë në shkëmbimin e informatave ndërmjet jugut e veriut të Mitrovicës. Gjatë anketimit, ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikojë çfarëdo mbledhje të BMA-ve në Mitrovicën e Veriut, edhe pse ka çmim të garantuar për blerje të tyre nga disa kompani në Mitrovicën e Jugut. Gjatë anketimit në terren u vërejtën disa investime të konsiderueshme në këtë sektor (p.sh. fabrika për prodhimin e vajrave esenciale në Leposaviq); instalimi i ri për tharjen e bimëve mjekësore dhe aromatike në Istog që drejtpërdrejt varet nga mbledhja e informatave të duhura për produktet dhe mbledhësit në rajon dhe organizimin e mbledhjes së sasive të mjaftueshme të BMA-ve.

Zgjidhjet e mundshme

- **Zhvillimi i regjistrin të palëve relevante të interesit** në bashkëpunim me institucionet vendore dhe OJQ-të ekzistuese në rajonin e synuar. Regjistri do të duhet të përmirësonte rrjedhën e informatave në zinxhirin e vlerave si dhe bashkëpunimin ndërmjet veriut dhe jugut të Mitrovicës.

8.1.4 Çështja

Përmirësimi i koordinimit të aktiviteteve ndërmjet të gjitha palëve të interesit në rajonin e Mitrovicës.

Përfundimet

Gjatë hulumtimit është vërejtur se niveli i mbledhjes dhe përpunimit të PPJD-ve si dhe niveli i prodhimit bujqësor organik është i limituar (0.03% hapësirë bujqësore dhe vetëm 10 prodhues në të gjithë territorin). Viteve të fundit, programe të ndryshme nga donatorët kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit në zonën e synuar, por strategjia vendore për zhvillim nuk është formalizuar, planifikuar apo përpiluar me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Për shkak të kësaj, investimet në këtë sektor nuk menaxhohen në mënyrën më efikase dhe më efçiente. Për këtë arsye, është i nevojshëm sistematizimi i menaxhimit të këtij sektori duke përfshirë të gjitha palët e interesuara (institucionet vendore, ekonominë, organizatat donatore, organizatat edukative, etj).

Zgjidhjet e mundshme

- **Themelimi i Qendrës Rajonale për zhvillimin e PPJD-së dhe bujqësisë organike**, qëllimi i së cilës do të ishte organizimi, udhëzimi dhe koordinimi i zhvillimit të qëndrueshëm të këtyre

sektorëve përmes përkrahjes dhe/ose realizimit të aktiviteteve, ofrimi i shërbimeve të mira për organizatat donatore, tërheqja e investimeve në rajonin e Mitrovicës, përdorimi i fondeve të BE-së që përkrahin bujqësinë organike, bashkëpunimi dhe realizimi i politikave nacionale për sektorin, startimi i projekteve për përmirësimin e efikasitetit të aktiviteteve të investuara dhe atyre të implementuara, krijimi i lidhjeve ndërmjet të gjitha palëve të interesit në zinxhirin e vlerave të identifikuar, bashkëpunimi me organizatat edukative, fillimi i aktiviteteve për zhvillimin e sektorit, fushatat promovuese, përkrahja e tregut të PPJD-ve dhe produkteve organike, zhvillimi i ekipit të konsulentëve dhe shërbimeve këshilldhënëse dhe aktivitetet tjera për përmirësimin e këtij sektori.

8.2 Çështjet rreth përmirësimit të lidhjeve horizontale dhe vertikale

8.2.1 Çështja

Kopjimi i modeleve të suksesshme të integritit vertikal që funksionon në shtetin e PPJD-ve

Përfundimet

Kompania Agroproduct është një prej prijësve në procesin e kultivimit dhe përpunimit të bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë. Edhe pse nuk ndodhet në rajonin e Mitrovicës, ajo ka zhvilluar rrjetin me shumë bashkëpunëtorë në mbarë Kosovën, disa nga të cilët ndodhen në rajonin e Mitrovicës. Kjo kompani është e angazhuar edhe në blerjen e BMA-ve dhe në anën tjetër përkrahë në mënyrë aktive kultivimin e BMA-ve., duke organizuar kështu një sistem të plotë të integritit vertikal, përfshirë këtu edhe prodhimin e fidanëve dhe shpërndarjen tek fermerët bashkëpunëtorë, ofrimin e shërbimeve këshillimore tek kultivuesit, kontraktimin me kultivuesit dhe garantimin e blerjes me çmime të dakorduara paraprakisht. Karakteristikat e këtij prodhimi janë të përshtatshme për llojin e familjeve bujqësore në rajonin e Mitrovicës dhe mund t'u ofrojë të hyra për jetesë që përndryshe do të ishte e vështirë të arrihej me produkte tjera bujqësore. Ky model i integritit vertikal haset rrallë në rajon dhe mund të përdoret si shembull pozitiv që duhet kopjuar për rastin e prodhimit të frutave të imëta.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja e **zhvillimit të mëtutjeshëm të aktiviteteve për mbledhjen dhe kultivimin e BMA-ve.** Përhapja e këtyre aktiviteteve në rajonin e Mitrovicës së Veriut, duke përfshirë mbledhësit apo kultivuesit e rinj mund të ofrojë mjete jetese për shumë familje në këtë rajon. Kopjimi apo zhvillimi i mëtutjeshëm i modelit të Agroproduct duhet marrë në konsideratë gjatë këtij procesi.
- **Përkrahja e zhvillimit të modelit të integritit vertikal në prodhimin e frutave të imëta,** në partneritet me NVM-të dhe OJQ-të e përzgjedhura nga rajoni i synuar, duke përdorur përvojën e Agroproductit në prodhimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Ky sistem duhet të bazohet në shembuj pozitiv dhe të përshtatet sipas specifikave të rajonit.
- Përkrahja e fillimit të prodhimit të vajrave esenciale në Leposaviq, përmes organizimit të rrjetit të mbledhësve dhe kultivuesve në rajonin e Mitrovicës së Jugut dhe Veriut. Ndërtimi i fabrikës përpunuese për prodhimin e vajrave esenciale dhe blerja e pajisjeve për përpunim janë në fazën përfundimtare. Kjo kompani do të ketë nevojë për përkrahje thelbësore në prodhimin e lëndës së parë përmes organizimit të aktiviteteve të mbledhjes apo kultivimit.

- **Përkrahja e prodhimit të synuar të dredhëzave pyjore në partneritet me importuesit e identifikuar ndërkombëtarë**, sipas kërkesave të tregut të eksportit. Ekziston një kërkesë e konsiderueshme për dredhëza pyjore (si të freskëta ashtu edhe të ngrira) në tregun e BE-së. Ekipi i projektit ka qenë në gjendje që të identifikoj disa prodhime testuese të dredhëzave pyjore në rajonin e Mitrovicës. Ky proces do të kërkojë identifikimin e palëve vendore të interesit që duhet të koordinojnë fermerët vendorë, të ofrojnë kushte të përshtatshme për magazinim dhe të organizojnë prodhimin në nivel vendorë. Krijimi i lidhjeve të drejtpërdrejta me blerësit ndërkombëtarë do të sigurojë qasje në disa tregje eksporti dhe organizimin e prodhimit sipas kërkesave të atyre tregjeve.

8.2.2 Çështja

Përkrahja e zhvillimit të modelit të kooperativës si një mjet efikas për përmirësimin e lidhjeve horizontale ndërmjet fermerëve në rajon.

Përfundimet

Aktualisht, në rajonin e Mitrovicës nuk funksionojnë kooperativa moderne. Disa kooperativa që funksionojnë në Mitrovicën e Veriut kanë shumë çështje që lidhen me procesin aktual të privatizimit dhe organizimi i tyre dhe funksionet janë krejtësisht të ndryshme nga funksionet e kooperativave moderne. Lloji i prodhimit dhe karakteristikat e fermave vendore sugjerojnë që inicimi i kooperativës moderne do të mund të përmirësonte konkurrueshmërinë e fermerëve të vegjël. Kjo vlen veçanërisht në organizimin e praktikave të kultivimit. Themelimi i kooperativave në një mjedis ku ka shumë pak besim apo kornizë të dyshimtë ligjore është detyrë e vështirë që do të kërkonte përkrahje të konsiderueshme nga ekspertët.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja përmes njëpilot projekti në **zhvillimin e modelit të kooperativës me të gjitha karakteristikat e kooperativës prodhuese moderne**. Kjo strukturë do të duhet të ofronte lëndë më të lirë mbjellëse, të rrisë shitjet e fermerëve anëtarë të kooperativës, të ofrojë shërbime të zgjeruara për anëtarët e saj dhe të përmirësojë fuqinë e tyre negociuese në treg me përpunuesit apo tregtuesit. Kooperativa model e themeluar do të duhej të shërbente si një shembull për iniciativa tjera në Mitrovicë.

8.3 Çështjet rreth përmirësimit të marketingut të palëve të përfshira në Zinxhirin e Vlerave

8.3.1 Çështja

Përkrahja e procesit të gjetjes së tregjeve të përshtatshme për frutat e imëta.

Përfundimet

Aktualisht, eksportuesit marrin vendimet e tyre biznesore duke u bazuar në njohuri të pamjaftueshme për tregjet specifike dhe segmentet tregtare, në informata të pakonfirmuara për konkurrencën dhe pozicionimin e çmimit që zvogëlon gjasat e zhvillimit të planit të suksesshëm për eksport. Një prej problemeve më të mëdha që lidhen me prodhimin e frutave të imëta (mbledhja dhe kultivimi) tregjet e kufizuara vendore për shkak të specifikave të produkteve. Kultivimi i frutave të imëta gjatë

viteve të fundit ka pësuar rritje të konsiderueshme. Derisa prodhimi vendor është në rritje, tregu vendor nuk do të jetë në gjendje që të absorbojë të gjithë prodhimin vendor. Për të vazhduar me trendet aktuale të zgjerimit, është jetike që të merret në konsideratë eksporti për në tregje tjera.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja në **zhvillimin e studimeve për hyrjen në tregjet ndërkombëtare** që do t'u ndihmonte prodhuesve dhe tregtarëve vendorë që të identifikojnë tregjet e përshtatshme për eksport të frutave të imëta. Ky proces gjithashtu do të kërkojë identifikimin e tregjeve të eksportit që do të mund të pranohin produktet kosovare. Ky proces gjithashtu duhet të planifikojë kushtet që duhen përmbushur për tregjet e synuara të eksportit.
- Përkrahja e **iniciativave rajonale për markën²⁴ e produkteve PPJD të synuara** për t'i dhënë vlerë të shtuar produkteve të përzgjedhura. Rritja e kërkesës për produkte, apo rritja e vlerës së produktit përmes krijimit të markës rajonale, do të rezultonte në të hyra të rritura për fermerët në rajon.

8.3.2 Çështja

Përmirësimi i njohurive të eksportuesve kosovarë në lidhje me tregjet e përshtatshme të eksportit.

Përfundimet

Zgjidhja e kësaj do të kërkojë kryerjen e një hulumtimi gjithëpërfshirës që do të duhej të rezultonte me përzgjedhjen e tregjeve të përshtatshme të eksportit që i përgjigjen specifikave të prodhimit kosovar. Ky proces duhet gjithashtu të përkrahë zhvillimin e lidhjeve përkatëse me blerësit potencial nga tregjet e identifikuara. Në bashkëpunim me shoqatën ekzistuese të tregtisë, do të mund të identifikohen edhe panairë tjera në vendet potenciale për prezantimin e produkteve kosovare. Është e rëndësishme që përzgjedhja e këtyre panairëve të bëhet duke u bazuar në strategjitë qartë zhvillimore për hyrje në tregje të përshtatshme të eksportit ku produktet e Kosovës kanë potencial për zgjerim.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja në **organizimin e vizitave të blerësve tek përpunuesit apo eksportuesit e përzgjedhur të PPJD-ve**. Ky proces do të përmirësonte lidhjet ndërmjet prodhuesve vendorë dhe importuesve potencial nga tregjet e përzgjedhura.
- **Organizimi i Shtandit Institucional në BioFach apo panairë tjera tregtare** në bashkëpunim me donatorë. Këto ngjarje do të ndihmonin në procesin e krijimit të kontakteve me blerësit potencial dhe partnerët dhe në krijimin e partneriteteve të ardhshme strategjike. Kjo gjithashtu do të ofrojë qasje në njohuritë më të fundit në bujqësinë organike, teknologjitë e reja të përmirësuar dhe praktikatat menaxhuese.
- Përkrahja e **organizimit të udhëtimeve studimore** për prodhues të përzgjedhur nga rajoni. Ky proces do të avanconte njohuritë e tyre dhe do të ndihmonte në procesin e krijimit të partneriteteve me importuesit potencial.

8.4 Çështjet rreth përmirësimit të prodhimit të NVM-ve

8.4.1 Çështja

Përmirësimi i sistemit të shërbimeve këshillimore për fermerët në rajon.

Përfundimet

Aktualisht, ne nuk kemi mundur të identifikojmë ndonjë sistem formal të shërbimeve këshillimore në rajonin e synuar. Mungesa e shërbimeve këshillimore zvogëlon kapacitetin dhe konkurrueshmërinë e fermerëve kosovarë. Zhvillimi i sistemit efikas në shpenzime dhe të qëndrueshëm të shërbimeve këshillimore që do t'u shërbente nevojave të fermerëve vendore duhet të jetë një nga objektivat kryesore të çfarëdo intervenimi përkrahës.

Zgjidhjet e mundshme

- Marrja në konsideratë e **zhvillimit të modelit efikas në shpenzime dhe të qëndrueshëm të shërbimeve këshillimore** për të avancuar iniciativat ekzistuese vendore për këto shërbime. analizës, kemi hasur në disa shembuj të ofrimit të shërbimeve këshillimore (IADK) në përkrahje të fermerëve vendorë në rajonin e synuar. Aktualisht këto iniciativa varen nga asistenca e donatorëve pa të cilën, prej kur kanë filluar, do të kishin mundësi të kufizuara për të mbijetuar. Sistemi i shërbimeve këshillimore duhet të mundësojë avancimin e njohurive të fermerëve përmes transferimit dhe kopjimit të përvojave pozitive rajonale në përdorimin e teknologjisë apo proceseve alternative të komunikimit.
- Marrja në konsideratë e **zhvillimit të strategjisë afatmesme për laboratorin në Universitetin Teknik të Mitrovicës së Veriut**. Ideja e themelimit të laboratorit në Universitetin Teknik të Mitrovicës së Veriut është në fazën fillestare. Koncepti është që të ofrohet përkrahje për shfrytëzim më të mirë të burimeve në dispozicion, prandaj akomodimi më i mirë i këtij laboratorit në kornizën ligjore të Kosovës për PPJD duhet të jetë prioritet.

8.4.2 Çështja

Përmirësimi i konkurrueshmërisë së produkteve vendore përmes përmirësimit të funksioneve për trajtim pas vjeljes.

Përfundimet

Gjatë vizitës, ekipi ka identifikuar aktivitete të limituara për trajtim pas vjeljes që do të mundësonin rritje të vlerës së produktit dhe të ofronte mundësi për t'u orientuar kah tregjet e zhvilluara të BE-së. Kompanitë, siç janë AS Promet nga Leposaviqi apo Agroproduct nga Istogu, tashmë kanë filluar me disa funksione për trajtim pas vjeljes, por edhe në këto raste produkti i tyre final ende konsiderohet si lëndë e parë për përpunim të mëtutjeshëm. Identifikimi i prijësve vendorë në rajonin e synuar që janë të interesuar në avancimin e funksioneve të tyre për trajtim pas vjeljes do të ndihmonte në cilësinë e prodhimit vendor.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja në **futjen e funksioneve të avancuara për trajtim pas vjeljes (pastrimi i boronicave, tharja e frutave të imëta dhe/ose kërpudhave, ambalazhimi më i mirë, përmirësimi i kategorizimit dhe kalibrimit, ruajtjes, etj) duke përdorur teknologjinë dhe pajisjet e avancuara** për NVM-të e përzgjedhura. Ky proces do të rezultojë në krijimin e sistemit të me-

kanizmave për trajtim pas vjeljes që do të përmirësojnë vlerën e produktit. Ky proces duhet mbështetur përmes ofrimit të përkrahjes adekuate teknike dhe pajisjeve. Ky model duhet kopjuar në kompanitë tjera në rajon sa herë që është e mundshme.

- Përkrahja në **përgatitjen e materialit teknik promocional që përshkruan teknologjitë e avancuara të përpunimit**. Ky material duhet të synoj përpunuesit vendor, duke u ofruar atyre informatat e duhura në lidhje me teknologjitë e reja të përpunimit.

8.4.3 Çështja

Përkrahja e funksioneve vendore për prodhimin e fidaneve.

Përfundimet

Gjatë këtij hulumtimi, ekipi ka identifikuar disa iniciativa vendore për prodhimin e fidaneve. Rritja e kapacitetit, sasisë dhe cilësisë së prodhimit vendor të fidaneve do të rezultojë në konkurrueshmëri të përmirësuar të fermerëve vendorë. Mungesa e fidaneve të cilësisë së mirë është një ndër faktorët kryesorë kufizues në arritjen e rritjes më të madhe në sektorin e kultivimit të frutave të imëta.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja e **prodhimit vendor të fidaneve për fruta të imëta dhe bimë mjekësore dhe aromatike** dhe lidhja e funksioneve të prodhuesve vendorë të fidaneve me qendrat e njohura ndërkombëtarisht për prodhimin e tyre. Kjo strategji do të sigurojë transferim të teknologjisë dhe prodhim të llojeve të reja të fidaneve që do të ofronte vlerë më të mirë për fermerët vendorë. Kjo gjithashtu duhet kombinuar me ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët.

8.4.4 Çështja

Rritja e kultivimit të frutave të imëta dhe bimëve mjekësore dhe aromatike dhe fillimi i prodhimit organik.

Përfundimet

Numri i kultivuesve në Kosovë është duke u rritur, për shkak të ndihmës së pranuar nga organizata të ndryshme donatore. Aktualisht, niveli i prodhimit organik është shumë i ulët (0.03% e hapësirës në dispozicion dhe rreth 10 prodhues të identifikuar). Kultivimi i frutave të imëta nuk kërkon hapësira të mëdha dhe ka tendenca të varet nga madhësia e familjes që do të mund të angazhohej në prodhim (d.m.th. është aktivitet që kërkon punë intensive). Si rezultat i projekteve të ndryshme të donatorëve, prodhimi i dredhës në Kosovë është rritur dukshëm gjatë 10 viteve të fundit. Në të kaluarën gjithashtu kemi qenë dëshmitarë të trendeve në rritje të kultivimit të frutave të imëta (kryesisht mjedrës dhe manaferrës) që duket se janë të përshtatshme për kushtet klimatike të Kosovës. Vazhdimësia e këtij trendi do të kërkonte arritjen e një ekonomie të shkallës që do të mundësonte rritje të mëtutjeshme të sektorit.

Zgjidhjet e mundshme

- Përkrahja në rritjen e numrit të kultivuesve përmes **krijimit të një numri të hapësirave demonstruese me përpunuesit ekzistues**. Këto ferma do të shërbejnë si pika promovuese dhe pika trajnimi, duke prezantuar praktika të avancuara bujqësore dhe promovimin e kultivimit të varieteteve të reja dhe hapësirave model për prodhim organik të produkteve të

caktuara. Ky proces duhet të jetë i koordinuar me NVM-të ekzistuese që janë të interesuara në krijimin e marrëdhënieve kontraktuale me fermerët, për t'iu garantuar atyre blerjen dhe për t'iu ofruar përkrahje në procesin e prodhimit.

- Përkrahja e organizimit të **prodhimit të frutave të imëta organike në baza pilotuese**. Ky proces do të sigurojë identifikimin e produkteve të përshtatshme që kanë treg vendor të garantuar, do të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorëve vendorë lidhur me përparësitë e prodhimit organik, do të ofrojë përkrahje për prodhuesit e identifikuar vendorë në organizimin e prodhimit organik, do të përgatisë udhëzime të përshtatshme teknike dhe do të ofrojë përkrahje në procesin e certifikimit organik.
- Përgatitja e një numri të **video materialeve teknike ku përshkruhet procesi i kultivimit**. Përgatitja e këtij materiali duhet bërë në konsultim me integruerit e interesuar.
- Marrja në konsideratë e **themelimit të sistemit për informata teknike** që mund të ofrojnë këshilla adekuate për fermerët në rajon në lidhje me përdorimin e pesticideve adekuate, plehrave artificiale apo implementimin e masave të ndryshme në procesin e kultivimit varësisht nga kushtet klimatike në rajon. Ky proces do të kërkonte lidhjen e rrjetit të stacioneve vendore meteorologjike, blerjen e softuerit të përshtatshëm dhe organizimin e procesit të shpërndarjes së informatave që do të tentonte të synonte drejtpërdrejt shumicën e kultivuesve vendorë.

8.5 Çështjet rreth përmirësimit të qasjes në kapital

8.5.1 Çështja

Përmirësimi i kapaciteteve të NVM-ve në lidhje me aplikimin për grante.

Përfundimet

Ekzistojnë disa struktura që ofrojnë grante mbështetëse për rritjen e konkurrueshmërinë së NVM-ve në Kosovë. Gjatë hulumtimit dhe diskutimeve me NVM-të ishte e qartë se ka paqartësi të mëdha dhe mungesë të informatave në lidhje me procesin që ka të bëjë me grante që jepen nga disa organizata donatore apo agjenci të udhëhequra nga institucionet qendrore. Aplikuesve shpesh u ka munguar kuptimi për procesin e përzgjedhjes, llojin e informatave të nevojshme për përgatitjen e propozimit fitues, apo njohuritë për të pasqyruar idetë e tyre në letër. Pronarët e kompanive shpesh kanë keqkuptime lidhur me procesin e shpërndarjes së granteve dhe nuk e kuptojnë rëndësinë e përzgjedhjes së konsulentëve të përshtatshëm që janë në gjendje të përpilojnë aplikimet e duhura për grante. Përveç kësaj, aplikuesve shpesh u mungon plani zhvillimor strategjik i cili i pamundëson që të përgatisin dokumentet për aplikim. Strukturat mbështetëse ekzistuese (konsulentët individual, OJQ-të apo kompanitë konsulente) ende nuk janë zhvilluar siq duhet që të jenë në gjendje të ndihmojnë në nevojat e këtyre kompanive. Edukimi i NVM-ve dhe trajnimi i strukturave mbështetëse duhet të jetë një nga prioritetet për përdorim të qëndrueshëm të skemave financiare mbështetëse në dispozicion.

Zgjidhjet e mundshme

- Avancimi i njohurive të vendorëve për **përgatitjen e dokumenteve për aplikim për grant**. Në bashkëpunim me OJQ-të aktive në rajon duhet zhvilluar trajnime të duhura për të përkrahur përgatitjen e aplikacioneve.

- Organizimi i **programeve për ngritje të kapaciteteve** për OJQ-ve vendore, kompanitë konsulente apo konsulentët vendorë për përgatitjen e propozimeve të duhura për aplikim për grante në sektorin e PPJD-ve.

8.5.2 Çështja

Përmirësimi i programit aktual institucional për përkrahjen e kompanive aktive në zinxhirin e vlerave të PPJD-ve.

Përfundimet

Duke marrë në konsideratë madhësinë e fermave në rajonin e synuar, ofrimi i përkrahjes së vazhduar financiare do të duhej të siguronte një qëndrueshmëri afatgjatë në këtë sektor. Strukturimi i duhur i ndihmës së ofruar nga institucionet dhe drejtimi i saj tek fermerët e duhur është gjithmonë sfidë. Aktualisht, projektet e përkrahura financohen 60% nga institucionet kosovare dhe 40% nga përfituesit. Aktualisht, ata janë duke përkrahur mbledhësit me grante prej 5,000 € deri në 30,000 € si pjesë e Masës IPA 302. Në të njëjtën kohë, institucionet e konsiderojnë sektorin e PPJD-ve dhe kultivimin e tyre si një prej sektorëve strategjik të bujqësisë kosovare.

Zgjidhjet e mundshme

- **Analizimi i mekanizmave aktual institucional për përkrahje financiare në Kosovë** dhe propozimi për përmirësim. Ky duhet të jetë një proces i vazhdueshëm që ofron shpjegime (feedback) të vazhdueshme për institucionet lidhur me efikasitetin e masave përkrahëse të ofruara dhe propozimet për përmirësim konkrete për këtë proces. I tërë procesi duhet të menaxhohet nga OJQ-të vendore në koordinim me NVM-të nga rajoni.

Shtojca 1 – Lista e të intervistuarve

	Emri dhe mbiemri	Institucioni/organizata	Sektori	Vendndodhja
1	Kastriot Këpuska	TEB Bank	Bankë	Prishtinë
2	Ganimete Rexhepi	Vijator	Transport	Prishtinë
3	Armend Hoxha	ProCreditBank	Bankë	Prishtinë
4	Benar Kelmendi	Intereuropa	Transport	Prishtinë
5	Nusrete Doda Gashi	Minisria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Institucione Kosovare	Prishtinë
6	Faruk Bojaxhi	Agjencia Kosovare e Pyjeve	Institucione Kosovare	Prishtinë
7	Fadil Millaku	Fakulteti i Biologjisë, Departamenti i Botanikës	Universiteti Hasan Prishtina	Prishtinë
8	Visar Idrizi	Vi-Print	Kompani dizajnimi dhe printimi	Mitrovicë
9	Benar Kelmendi	Intereuropa	Transport	Prishtinë
10	Alban Dedi	Kanun	Marketing dhe reklama	Prishtinë
11	Fatmir Selimi	USAID NOA	Kontraktues i USAID ARD	Prishtinë
12	Vlora Basha	Index Kosova	Institucion hulumtues	Prishtinë
13	Hysni Veseli	Hysi	Qendër grumbullimi PPJD	Vushtrri
14	Halit Avdijaj	Agroproduct	Eksportues i PPJD-ve	Istog
15	Xhemshit Veliu	AgroFlorentina	Qendër grumbullimi PPJD	Polac
16	Zenel Bunjaku	IADK	NGO	Vushtrri
17	Bedri Bajrami	Komuna e Mitrovicës	Institucione Kosovare	Mitrovicë
18	Adem Fejzullahu	Bajgorë	Qendër grumbullimi	Bajgorë
19	Halid Avdiaj	Agrosuna	Magazinë e ftohët/Qendër grumbullimi	Istog
20	Nebojsa Arsić	Universiteti i Prishtinës	Edukim	Mitrovicë
21	Aleksandar Ristovski	Universiteti i Prishtinës	Edukim	Mitrovicë
22	Miljojko Petrović	Komuna e Leosaviqit	Institucione Kosovare	Leosaviq
23	Aleksandar Djukic	Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës	Edukim	Mitrovicë
24	Ivan Milojević	Peppermint	Përpunues i vajit eterik	Leosaviq

25	Časlav Radosavljević	GRM Impeks	Magazinë e ftohët	Mitrovicë
26	Dragan Vučković	Qendër grumbullimi Leposaviq	Qendër grumbullimi	Leposaviq
27	Miodrag Vučković	Qendër grumbullimi Leposaviq	Qendër grumbullimi	Leposaviq
28	Goran Vučković	Qendër grumbullimi Leposaviq	Qendër grumbullimi	Leposaviq
29	Dushko Minić	Universiteti i Prishtinës	Edukim	Mitrovicë
30	Rade Utvić	Utvić cooperation	Magazinë e ftohët/Qendër grumbullimi	Zubin Potok
31	Ivan Vukoičić	AS-Promet	Magazinë e ftohët/Qendër grumbullimi	Leposaviq
32	Dori Pavlovska Georgievska	IBCM	Edukim	Mitrovicë
33	Dragan Stanojević	Vule Komerc	Përpunues	Leskovc
34	Jelena Nenić, teknolog	FUNGO-JUG Leskovac	Përpunues	Leskovc
35	Mijodrag Nedeljković	STRELA	Përpunues	Leskovc
36	Radiša Petrović	Radiša Export Import doo	Përpunues	Kurshumli
37	Milan Živković	Grupi rajonal për pemë për Serbinë e Jugut	Spektori i PPJD-ve	Leskovc
38	Dragan Stanojević	Vule Komerc	Përpunues	Leskovc
39	Jelena Nenić, teknolog	FUNGO-JUG Leskovac	Përpunues	Leskovc
40	Mijodrag Nedeljković	STRELA	Përpunues	Leskovc
41	Radiša Petrović	Radiša Export Import doo	Përpunues	Kurshumli

Shtojca 2 – Programet e donatorëve për nën-sektorin e PPJD-ve²⁵

Donatorë		USAID
Projekti		Projekti Shërbimi Biznesor Kosovar, implementuar nga Chemonics, International, Inc.
Periudha e implementimit		2000 – 2003
Buxheti		N/A
Rajoni i mbuluar		Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore		<ul style="list-style-type: none"> - Studime të ndryshme për prodhimin dhe tregun e barërave - Ngritja e kapaciteteve për kultivimin e barërave - Ngritja e kapaciteteve për kërpudhat e egra lidhur me mbledhjen, trajtimin pas mbledhjes dhe marketingun - Lidhjet e zhvilluara me përpunuesit rajonal - Udhëtim studimor në rajon
Donatorë		Qeveria Zvicerane
Projekti		Promovimi i Hortikulturës në Kosovë, implementuar nga Intercooperation
Periudha e implementimit		2002 – 2012
Buxheti		500,000 EUR
Rajoni i mbuluar		Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore		<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i kultivimit i së paku pesë llojeve - Themelimi i një përpunuesi - Themelimi i së paku 10 qendrave të grumbullimit - Rritja e kapaciteteve njerëzore për prodhim dhe përpunim të bimëve mjekësore dhe aromatike - Zhvillimi i inventarizimit të PPJD-ve (pa përfshirë kërpudhat) - Fillimi i certifikimit organik – tri kompani të certifikuara
Donatorë		Qeveria Holandeze
Projekti		Rritja Ekonomike Rajonale për Stabilizim REGS – implementuar nga CARE Kosovë
Periudha e implementimit		2004 – 2010
Buxheti		1.6 milion EUR
Rajoni i mbuluar		Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore		<ul style="list-style-type: none"> - Themelimi i 10 qendrave të grumbullimit duke i përkrahur ato me tharëse dhe pajisje për përdorim pas vjeljes - Krijimi i broshurave për identifikimin e bimëve mjekësore

Donatorë		Qeveria Gjermane
Projekti		Promovimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat në zonat rurale, implementuar nga GIZ
Periudha e implementimit		2006 – 2014
Buxheti		N/A
Rajoni i mbuluar		Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore		<ul style="list-style-type: none"> - Studim marketingu për nën-sektorin e PPJD-ve - Vizita në panairët e përpunuesve të PPJD-ve në së paku 10 panairë ndërkombëtare p.sh. panairi BioFach - Ngritja e kapaciteteve të përpunuesve për marketingun e produkteve në tregjet e eksportit përmes trajnimeve dhe vizitave studimore - Zhvillimi i “librit të kuq” të bimëve mjekësore - Zhvillimi i strategjisë nacionale për nën-sektorin e PPJD-ve në bashkëpunim me MBPZHR-në dhe MMPH-në.
Donatorë		USAID
Projekti		Programi Kosovar për Ndërmarrje, implementuar nga Booz Allen Hamilton
Periudha e implementimit		2008 – 2012
Buxheti		17.3 milion USD – i tërë projekti
Rajoni i mbuluar		Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore		<ul style="list-style-type: none"> - Themelimi i hapësirave për ftohje - Përkrahja për implementimin e standardit HACCP - Pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare p.sh. Fancy food SHBA - Udhëtim studimor në rajon dhe BE
Donatorë		Qeveria Finlandeze
Projekti		Asistenca Pregaditore në Dragash
Periudha e implementimit		2008-2010
Buxheti		403,623 EUR
Rajoni i mbuluar		Komuna e Dragashit
Objektivat		<p>Krijimi i kornizës për zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Dragashit dhe zvogëlimin e humbjeve të biodiversitetit. Qëllimi është që në fund të projektit komunitetet e synuara do të mund të identifikojnë nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohen gratë dhe ndërmarrin veprime për adresimin e tyre përmes qasjes përfshirëse në komunitet.</p> <p>Projekti ka ofruar përkrahje në themelimin e Autoritetit Drejtues ‘Sharprodhimi’ duke ndihmuar në formulimin e strategjisë së integruar për zhvillim si dhe implementimin e një sërë pilot-aktiviteteve që kanë kontribuar në krijimin e kornizës së qëndrueshme zhvillimore për komunën e Dragashit.</p>

Donatorë	Qeveria Finlandeze
Projekti	Zhvillimi i Bujqësisë / Programi për Zhvillim Shoqëror në Kosovë
Periudha e implementimit	2008-2010
Buxheti	1.2 milion EUR
Rajoni i mbuluar	Rajoni i Mitrovicës
Objektivat	<p>Zhvillimi i bujqësisë:</p> <p>Zhvillimi i prodhimit dhe ngritja e cilësisë së produkteve në sektorin e bujqësisë në Kosovën Veriore, ofrimi i mundësive për përpunim të mëtejshëm, rritja e të hyrave nga bujqësia dhe siguri se aktivitetet realizohen përmes procedurave të zakonshme të biznesit.</p> <p>Programi për zhvillim shoqëror:</p> <p>Fuqizimi i grave dhe barazisë në 15 fshatra rurale të Kosovës Veriore përmes trajnimit, aktiviteteve që sigurojnë të ardhura, rritje të vetdijes, mobilizimit, pjesëmarrjes efektive të komunitetit dhe rrjetëzimit.</p>
Donatorë	Qeveria Finlandeze
Projekti	Zhvillimi i Qëndrueshëm në Dragash
Periudha e implementimit	2009-2013
Buxheti	2.9 milion EUR
Rajoni i mbuluar	Komuna e Dragashit
Objektivat	Ofrimi i përkrahjes së vazhdueshme për krijimin e kornizës së qëndrueshme për Komunën e Dragashit, një nga komunat më të varfëra në Kosovë me biodiversitet të vlefshëm për Kosovën dhe Europën Juglindore.
Përshkrimi	Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm përqendrohet në: i) ruajtjen e biodiversitetit; ii) rikrijimin dhe zhvillimin e bizneseve lokale bazuar në shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës; iii) shërbime të bazuara në praktika të qëndrueshme dhe pro-ambientale të energjisë; dhe iv) ngritje të kapaciteteve dhe fuqizim të udhëheqësve komunal dhe grave në promovimin e zhvillimit dhe bashkëpunimit me nivelin qendror.
Donatorë	USAID
Projekti	Mundësitë e reja për Bujqësi, implementuar nga TetraTech
Periudha e implementimit	2011 – 2015
Buxheti	17.3 milion USD – i tërë projekti
Rajoni i mbuluar	Në mbarë Kosovën
Të arriturat kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Përkrahja për kultivimin e mbi 100 ha kamomil - Krijimi i 2 unazave makinerike për kultivim dhe vjelje të kamomilit - Pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare p.sh. BioFach, Gjermani

Donatorë	Qeveria Finlandeze
Projekti	Trajnimi i Këshilltarëve të Bujqësisë në Kosovë
Periudha e implementimit	2011-2013
Buxheti	353,000 EUR
Rajoni i mbuluar	Në mbarë Kosovën
Qëllimi i përgjithshëm	Krijimi i mundësive për punësim në sektorin e bujqësisë përmes rritjes së kapaciteteve të sistemit egzistues këshillimorë
Objektivat	<p>1) Rritje e kapaciteteve të 20 këshilltarëve bujqësor nga 3 komuna (Vushtrri, Skënderaj dhe Fushë Kosovë) dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) si dhe Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës të Univerzitetit të Prishtinës në Kosovë.</p> <p>2) Rritje e shitjeve dhe përmirësim i jetesës së fermerëve dhe akterëve të tjerë në sektorin e qumështit.</p>
Donatorë	Qeveria Finlandeze
Projekti	Ndihmë Tregtisë
Periudha e implementimit	2012-2016
Buxheti	1.4 milion EUR
Rajoni i mbuluar	Në mbarë Kosovën
Objektivat kryesore	<p>Qëllimi i përgjithshëm zhvillimor i projektit Ndihmë Tregtisë është nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse përmes promovimit të tregtisë dhe rritjes së konkurrueshmërisë së Kosovës. Duke njohur rëndësinë e tregtisë dhe industrisë në ekonominë në zhvillim dhe ndikimin e tyre pozitiv në punësim dhe ulje të varfërisë, projekti fokusohet në intervenime konkrete drejt përmirësimit të performancës ekonomike në afat të gjatë duke forcuar kapacitetet për pjesëmarrje dhe përfitim nga tregtia ndërkombëtare.</p> <p>Projekti ofron asistencë teknike dhe përkrahë zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në zhvillimin dhe zbatimin e reformave tregtare të bazuara në evidencë. Në bashkëpunim me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe fermerëve në Rajonin Ekonomik Jugor (REJ) dhe rajonin e Mitrovicës, projekti angazhohet në rritjen e prodhimit, punësimin dhe ndërmarrësisë përmes qasjes gjinore dhe kontributit në përmirësimin e jetesës.</p>

Shtojca 3 - Referencat

1. Vlerësimi Bazë i Rajonit Ekonomik Jug – publikuar nga UNDP-ja, 2014
2. Konferenca për Rolin e Gruas në Pylltari në Kosovë – publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kosovë, 2013
3. Integrimi i Mjedisit në Progresin dhe Prospektet e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore – publikuar nga Banka Botërore, 2007
4. Strategjia për Mundësitë Bujqësore të Kosovës - BoozAllen, Hamilton, 2010
5. Konkurrueshmëria e Kosovës dhe Vlerësimi Rregullator i Zinxhirëve të Përzgjedhur të Vlerave në Hortikulturë, Roger Cozens, Fatmir Selimi, Christian Filipov and Martin Maher, Kosovë, 2014
6. Raporti i Gjelbër i Kosovës, 2014 – publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë, Kosovë, 2014
7. Inventari i Pyjeve të Kosovës - publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kosovë, 2012
8. Raporti për Kosovën – publikuar nga konsorciumi Arcotrass, financuar nga Komisioni Evropian, Kosovë, 2006
9. Strategjia Kombëtare për Sektorin e Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPJD) 2014-2020 – publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kosovë
10. Politikat dhe Dokumenti Strategjik për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve, 2010-2020 – publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kosovë, 2009
11. Kalendari i produkteve, Harta e Zinxhirit të Vlerave të Sektorit Pyjor në Dragash, Kosovë, Adolfo Rosati (ekspert i zinxhirit të vlerave të sektorit pyjor), 2013
12. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011-2020 – publikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2010, Kosovë
13. Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pylltarisë, Vehbi Sotiu, Shtator 2013, Tetovë, IRJ e Maqedonisë.
14. Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë (KPEP) i USAID-it, Veronica R. Bartolome, Nazmi Pllana, implementuar nga Booz Allen Hamilton, 2009
15. Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2014, publikuar nga UNDP-ja, 2014



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

